



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit  
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije  
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

QENDRA PËR VLERËSIM

# TESTI I MATURËS

Gjuhë Shqipe dhe Letërsi  
Gjuhë Angleze  
Matematikë  
**Lënda Zgjedhore**

---

*Emri dhe mbiemri i nxënësit*

---

*Shkolla*

**Forma**



Qershor, 2025

## Udhëzime

### Koha:


Keni 150 minuta që t'u përgjigjeni 100 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t'i zgjidhni kërkesat.

### Si të veproni?

1. Luteni që të verifikoni a është e njëjtë forma e **Testit** me formën e **Fletëpërgjigjes** (A me A, B me B, etj.)
2. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha shifrat e kodit tuaj unik (në rreth), i cili është në formatin: **MS - 25XXXXX**. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
3. Para se të filloni t'u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t'ju ndihmojë.
4. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.

Numri **1(një)** paraqet numrin e pyetjes në fletën e përgjigjeve

Përgjigja e saktë, në fletën e përgjigjeve, duhet plotësuar në këtë mënyrë me laps të thjeshtë HB



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në **Test** dhe në **Fletëpërgjigje**.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

**Lexo tregimin në vijim dhe përgjigju pyetjeve!**

Në muzgun e dhjetorit, në orën kur kupolat e pallateve dhe të katedraleve rishpërndanin ndriçimin e fundit të ditës që po shuhej, ajo nisi të krihej përpara pasqyrës. Duart e saj delikate e të zbehta nisën të lëviznin me njëfarë nervozizmi, ngaqë, me sa dukej, nuk po e gjente dot modelin e duhur. Një karficë e pruar, rrëzëllimin e zbehtë të së cilës ajo e zhvendosi disa herë sipër flokëve e lodhi edhe më tepër.

Ndihej menjëherë se atë e lodhi shumë kjo e krehur tepër e gjatë, ngaqë nuk kishte ende përvojë për një gjë të tillë. Ajo ishte dymbëdhjetë vjeçe dhe ishte hera e parë në jetën e saj që po krihej kaq gjatë dhe kaq me kujdes. Veç kësaj, ajo ishte e shtruar prej kohësh në spital, ku porsa kishte mbaruar fazën e parë të kurimit nga leuçemia.

Flokët, që kohë më parë i ishin rralluar e rënë prej sëmundjes, i qenë rritur përsëri, të bukur e të mëndafshhtë, siç i kishte pasur edhe më parë, por nuk ishte ky ngazëllim i rikthimit të tyre shkak për atë krehje aq të kujdesshme në atë buzëmbremje dhjetori. Nuk ishte as ndonjë arsye vajzërore: një pëlqim a pasion për dikë, që sëmundja e gjatë, sidomos prania e afërt e vdekjes, mund t'ia kishin afruar para kohe moshës së saj. Jo, arsyeja ishte tjetër gjë dhe, në dukjen e parë, ngjante e thjeshtë: profesori, që e kuronte prej kohësh, e kishte ftuar atë mbremje në shtëpinë e tij.

Qysh se kishte mbërritur në atë kryeqytet të huaj për kurim, ishte herë e parë që një vendës e ftonë në familjen e tij. Dhe ky vendës nuk ishte i zakonshëm, por një nga mjekët më të shquar për kurimin e leuçemisë, jo vetëm në atë vend, por në krejt Europën. Vajza ishte e gëzuar dhe krenare për ftesën, aq më tepër që profesori i kishte thënë se për hir të saj, për hir të pacientes së tij të vogël nga Shqipëria, ai kishte ftuar gjithashtu një numër miqsh të tij.

Bashkë me gëzimin, vajza kishte ndier një lloj ankthi: si do t'u dukej vallë ajo atyre burrave dhe grave kryeqytetase, që qysh tani i përfytyronte të ulur në poltronat e sallonit të madh, duke folur shkujdesshëm si në filma?

Vajza quhej Eglë, por ajo e dinte se për të gjithë ata nuk do të ishte veçse “shqiptarja e vogël”, “die kleine albanerin”. Vajza kishte vënë re se këto dy fjalë shkaktonin në sytë e njerëzve njëfarë kureshtjeje. Ata e vështronin një copë herë dhe diçka thoshin për të. Vajza kishte filluar të kuptonte gjermanishten, do ta ndiente me intuitë se e folura e tyre s'kishte lidhje me sëmundjen e saj. Prej kohësh ajo e dallonte të folurën për sëmundjen, nga ajo tjetra, e zakonshme.

– Ajo kupton gjermanisht, – u kujtonin të tjerëve mjeku ose infermierja e saj gjatë konsultave. Pas këtij paralajmërimi ata frenonin të folurën ose e vazhdonin atë me fjalë të tjera.

Prej kohësh vajza e kishte kuptuar se emri i vendit të saj zgjonte te të huajt një kureshtje, e cila ishte e mirë, neutrale ose disa herë e keqe. Pas shqiptimit të fjalëve “kleine albanerin” vinte një çast ngrirjeje, kur vajza kthehej e gjitha në vëmendje për të kapur aksionin e përbashkët të blusë së syve, të vijës së buzëve apo një lëvizje të mollëzave të tjetrit, prej të cilit dilte një nga ato tri llojet e kureshtjes, pas së cilës vajza ndihej e gëzuar, boshe ose tejet e pikëlluar. Para se ta nisnin për herë të parë jashtë shtetit, një dajë i saj i kishte thënë se vendin e saj e respektonin të gjithë “atje”, ngaqë ishte një vend socialist. Por një ditë tjetër, po ai i kishte thënë se pikërisht ngaqë ishte socialist, vendin e saj nuk mund ta donin atje.

Ajo filloi të qëndronte përpara pasqyrës, të zgjidhte me kujdes veshjen dhe të pyeste infermierën se cili model i flokëve i shkonte më tepër.

Në qoftë se muajt e fundit ajo e kishte bërë këtë çdo ditë (çdo ditë në atë zinxhir ditësh të trishtueshme, monotone spitali), merrej me mend se sa me përkushtim vajza nisi të krihej në atë pasdite dhjetori.

Ajo e ndjeu shqetësimin e profesorit dhe, e mënjano pak, dëgjoi shpjegimet që po i jepte atij infermierja. Ajo kuptoi fjalët “u kreh shumë gjatë”, “deshi të bëhej sa më e bukur”, pas të cilave profesori për ta qetësuar e puthi në ballë në mënyrë të lehtë, fare të lehtë, që asaj i kujtoi, kushedi pse, një pikturë që e kishte parë në një kishë ose në një muze dhe që quhej “puthja e vdekjes”.

Shkëputur nga tregimi “*E krehura*”, Ismail Kadare

1. Historia e këtij tregimi paraqitet si një rrëfim i një rrëfimtari që:

- (A) kujdesej për të në spital dhe njeh ndjenjat dhe mendimet e Eglës.
- (B) ka fuqinë imagjinare të shprehë ndjenjat dhe mendimet e Eglës.
- (C) kishte mësuar nga mjeku i saj për jetën dhe sëmundjen e Eglës.
- (D) kishte mësuar nga kartela mjekësore e spitalit detajet e jetës së Eglës.

2. Ku zhvillohet kryesisht ngjarja që përshkruan narratori në tregim?

- (A) Në ambiente të brendshme të një spitali.
- (B) Në spital dhe në shtëpinë e profesorit që e kuron.
- (C) Në spital dhe në shtëpinë e infermieres.
- (D) Në një sallon ondulimi të një vendi të huaj.

3. Si ndihej Eglja gjatë qëndrimit në spitalin e një vendi të huaj?
- (A) E frikësuar se nuk do të kishte përkujdesjen e duhur mjekësore.
  - (B) E prekur nga përkujdesja e veçantë dhe mbështetja e stafit mjekësor.
  - (C) E pikëlluar nga mungesa e shpresës për shërim.
  - (D) E gëzuar për suksesin në mësimin e gjermanishtes.
4. Në fjalinë: “Prej kohësh vajza e kishte kuptuar se emri i vendit të saj zgjonte te të huajt një kureshtje, e cila ishte e mirë, neutrale ose disa herë e keqe”, çfarë kuptojmë për mënyrën si të huajt e njihnin Shqipërinë?
- (A) Njohja e tyre ishte e hollësishme, e rëndësishme ose e nevojshme.
  - (B) Njohja e tyre ishte e vlefshme, e besueshme ose domethënëse.
  - (C) Njohja e tyre ishte emocionuese, mahnitëse ose tronditëse.
  - (D) Njohja e tyre ishte pozitive, asnjëse ose here-herë negative.
5. Cila nga fjalitë në tregim është më enigmatike, duke nxitur më shumë pyetje dhe interpretime nga lexuesi?
- (A) ... vajza ndihej se atë e lodhi kjo e krehur tepër e gjatë.
  - (B) ... vajza do të kishte një pëlqim a pasion për dikë.
  - (C) ... vajza ndihej e gëzuar, boshe ose tejet e pikëlluar.
  - (D) ... vajza filloi të qëndronte përpara pasqyrës.
6. Në fjalinë: “... profesori i kishte thënë se për hir të saj, për hir të pacientes së tij të vogël nga Shqipëria, ai kishte ftuar gjithashtu një numër miqsh të tij”, fraza “**për hir të saj**” në këtë kontekst do të thotë:
- (A) për hijeshi të saj
  - (B) për dëshirë të saj
  - (C) për kërkesë të saj
  - (D) për nder të saj
7. Në fjalinë: “*Ishte e gëzuar dhe krenare për ftesën*”, kryefjala nuk është e shprehur drejtpërdrejt, por nënkuptohet. Cila fjalë në fjali e zëvendëson funksionalisht kryefjalën?
- (A) ishte
  - (B) e gëzuar
  - (C) krenare
  - (D) për ftesën
8. Pse Kadare e paraqet Eglën si “kleine Albanerin” (“shqiptarja e vogël”) dhe jo thjesht si një vajzë?
- (A) Për të treguar se ajo është një vajzë e zakonshme, njohja e identitetit kombëtar të së cilës nuk është i rëndësishëm.
  - (B) Për të nxjerrë në pah krenarinë dhe gëzimin e saj që përfaqëson një vend me vlera kombëtare.
  - (C) Për të paraqitur përvojën e saj personale si një histori individuale, pa e lidhur me përkatësinë e saj kombëtare.
  - (D) Për të theksuar ndarjen midis Eglës dhe shoqërisë së huaj, duke simbolizuar identitetin e saj kombëtar.
9. Çfarë përfundimi mund të nxjerrim për gjendjen emocionale dhe identitetin e Eglës pas leximit të tregimit?
- (A) Ajo ishte e hutuar dhe e shqetësuar si një e huaj e sëmure që vjen për kurim nga një vend i izoluar si Shqipëria.
  - (B) Ajo ishte e trazuar se si do të mund të fliste gjermanisht për të treguar bukuritë e vendit të saj.
  - (C) Ajo ndihej e pasigurt, sepse frikësohej si e huaj të reagoonte kur dëgjonte stafin mjekësor të fliste për Shqipërinë.
  - (D) Ajo ndiente shqetësim për faktin që nuk thirrej në emër, por identifikohet si “shqiptarja e vogël”.

10. Me figurën e Eglës, Ismail Kadare në këtë tregim përçon një mesazh thelbësor që lidhet me:

- (A) Guximin dhe vendosmërinë për të përballuar sfidat dhe frikën nga vdekja.
- (B) Kujdesin e vazhdueshëm për shëndetin si kusht për një jetë të gjatë.
- (C) Përkujdesjen, dashurinë dhe dhembshurinë si vlera njerëzore universale.
- (D) Përshtatjen dhe respektin ndaj gjuhës dhe zakoneve në vendet e huaja.

**Lexo poezinë në vijim dhe përgjigju pyetjeve!**

Dhe ju po shkoni,  
Bylbyla, kshtu!  
Po treni këndynaj,  
Dallndysha, ju!

Dekën mendova  
Se m'vjen kurdo;  
Se m'leni vetun  
S'mendova, jo

Por ma fort zemrën  
Ma bren një idhnim:  
Çerdhen qi i leni  
Kujdesit tim.

Ndoshta, kur t'ktheni  
Mue vorri m'mba,  
E ju kërkoni  
Çerdhën qi s'â.

**Ndre Mjeda**

11. Cili varg përmban një rrokje më shumë se të tjerët në strofën e tretë?

- (A) *Por ma fort zemrën*
- (B) *Ma bren një idhnim*
- (C) *Çerdhen qi i leni*
- (D) *Kujdesit tim*

12. Cila është forma standarde e shprehjes dialektore “Çerdhën qi s'â”?

- (A) Çerdhën qe s' ishte
- (B) Çerdhën që s' është
- (C) Çerdhën që s' ka qenë
- (D) Çerdhën qe s' qe

13. Pse është e rëndësishme të ruajmë poezi të shkruara në gegërishte, si kjo e Ndre Mjedës?

- (A) Sepse për të gjithë shqiptarët janë më të lehta për t'u lexuar dhe kuptuar.
- (B) Sepse duhet ta njohin ata që flasin në dialektin e toskërishtes.
- (C) Sepse është më e lehtë të kthehet në variantin gjuhësor të arbërishtës.
- (D) Sepse pasqyrojnë pasurinë kulturore dhe gjuhësore të shqipes.

14. Cila figurë letrare është e pranishme në vargun “Dhe ju po shkoni, / Bylbyla, kshtu!”?

- (A) Metafora
- (B) Simboli
- (C) Personifikimi
- (D) Epiteti

15. Si e shpreh poeti në këtë poezi ndjenjën e dhimbjes për braktisjen?

- (A) Përmes simboleve të vendit të braktisur, siç është çerdhja që mbetet pa kujdes.
- (B) Përmes përshkrimit të bukurisë së zogjve që largohen.
- (C) Përmes përshkrimit të vetmisë dhe ankthit që nuk mund të kujdeset.
- (D) Përmes shprehjes së pasigurisë për kthimin e të dashurve në atdhe.

### Lexo tregimin në vijim dhe përgjigju pyetjeve!

Ndonëse aktualisht vendi është ndikuar nga kushte të qëndrueshme atmosferike me masa ajrore të thata, një pjesë e konsiderueshme e territorit shqiptar, po përjeton temperatura mjaft të ulëta, acar dhe ngrica. Të ftohtin dhe pasojat e një moti me temperatura nën zero gradë, nuk i ndjen dhe i përjeton vetëm njeriu, por po aq të ndjeshme ndaj fenomeneve të tilla atmosferike, janë edhe bimët.

Ngricat janë shkaktare për më shumë dëme se të gjithë insektet, sëmundjet, brejtësit dhe barërat e padëshirueshme së bashku. Në dimrat e 1984 – 85 dhe 1986 – 87 në vendet e Evropës Perëndimore dhe Lindore u thanë miliona pemë. Ngricat pranverore janë dukuritë klimatike negative më të shpeshta që ndikojnë mbi prodhimtarinë e pemëve frutore dhe kufizojnë përhapjen e specieve dhe kultivarëve në zona të caktuara. Ngricat pranverore zakonisht ndodhin në netët e qeta gjatë orëve të fundit të natës dhe të para të mëngjesit, me qiej të kthjellët dhe pak erë.

Me rënien e temperaturave, ajri i ftohtë grumbullohet në fushëgropa dhe për shkak të mungesës së erës, nuk shpërhapet. Sa më e fortë dhe e zgjatur ngrica, aq më e thellë bëhet shtresa e të ftohtit.

Ngricat rrezatuese janë një shkak madhor për t'u shqetësuar në shumicën e rajoneve të prodhimit të drufruturëve të klimës së butë. Ngricat mund të jenë të ardhura, në rastin kur vijnë masa të mëdha ajri të ftohtë nga zonat polare, të cilat shpesh e mbajnë temperaturën nën zero edhe gjatë ditës. Në fund, ngricat mund të vijnë edhe nga avullimi që ndodh kur bimët janë të njomura dhe lagështia relative është aq e ulët sa të përcaktojë një avullim të fortë që tërheq me shpejtësi nxehtësinë nga bimët.

Ngricat dimërore, që mund të dëmtojnë bimët tropikale dhe nëntropikale, zakonisht nuk kanë ndikim mbi llojet drufrutore të klimës së butë në ato rajone që kanë klimë relativisht të butë. Megjithatë, pasi sythat gjethorë (drunorë, vegjetativë) dhe lulorë (frutor, gjenerativ) fillojnë të fryhen në pranverë, temperaturat nën 0°C mund të jenë dëmtuese. Në çeljen e sythit, kur nis të duket ngjyra e petlave, llojet drufrutore të klimës së butë shpesh tolerojnë temperatura nga -3 deri -5°C. Lulet që janë duke u hapur mund t'u bëjnë ballë temperaturave prej -2 deri -3°C, ndërsa në lulëzim të plotë, temperatura që variojnë nën -2 deri -3°C mund të ngordhin vezoren, e duke qenë se frutat janë formuar, ato mund të dëmtohen ose të ngordhin nga temperaturat nën -1 deri -2°C.

Këto temperatura dëmtuese janë të vlefshme për pjesën dërrmuese të pemëve frutore. Speciet më të ndjeshme midis pemëve frutore bërthamore janë pjeshka dhe kajsia, të ndjekura nga dardha dhe molla. Arrat, mjedrat dhe luleshtrydhet janë të ndjeshme ndaj temperaturave ndërmjet -1 dhe -2°C nga periudha e fryrjes së sythave e më pas. Rrushtë e serezit (*Ribes nigrum* L.) dhe rrushtë e frëngut (*Ribes uva-crispa* L.) duket se janë më tolerantë ndaj ngricave dhe lulet mund t'u mbijetojnë temperaturave -3 deri -4°C. Boronicat janë edhe më tolerante (afro -5°C), ndërkohë që lulet e lajthisë janë në gjendje të përballojnë -5°C.

Zakonisht lulet janë më të ndjeshme ndaj dëmtimit prej ngricave se sa gjethet. Megjithatë, tek aktinidja dhe hardhia, sythi i cili çel në pranverë prodhon një lastar gjethor (vegjetativ). Lulet shfaqen në atë lastar vetëm disa javë më vonë. Kësisoj, një ngricë që ndodh pas çeljes së sythit do t'a thajë tërë lastarin dhe ndërkohë që një lastar i ri mund të dalë nga baza e lastarit të vjetër, është pashmangshmërisht më pak frytifikues. Për aktinidën, janë kritike temperatura -1.5 deri -2.0°C ose më të ulëta; hardhia mund të tolerojë temperatura pakëz më të ulëta (-2 deri -3°C).

(Shkëputur nga artikulli i Prof. Dr. Endrit Kullaj: *Teknologjitë mbrojtëse prej dëmtimit nga ngricat, të pemëve frutore, vreshtave dhe bimëve subtropikale*)

16. Cila nga veçoritë më poshtë dëshmon që teksti është i natyrës informuese-shkencore?

- (A) Teksti përshkruan pasoja të ndodhive klimatike që shkaktohen nga gazet e dëmshme si dioksidi i karbonit.
- (B) Autori shpreh mendimin e tij rreth motit të ftohtë dhe përmend emocionet që lidhen me ndikimin te njerëzit dhe bimët.
- (C) Përdor një stil të gjallë dhe përshkruet për të tërhequr vëmendjen e lexuesit ndaj natyrës dhe stinëve.
- (D) Jep të dhëna, përdor terma specifikë dhe të dhëna të ekspertëve për të shpjeguar ndikimin e ngricave.

17. Cili është qëllimi i përgjithshëm i këtij teksti?

- (A) Të analizojë llojet e tokave bujqësore.
- (B) Të shpjegojë dëmet që shkaktojnë insektet te bimët.
- (C) Të japë një pasqyrë mbi ndikimin e ngricave në bimësi.
- (D) Të diskutojë kultivimin e luleshtrydhes në klimë të butë.

18. Cila prej fjalive më poshtë përshkruan më mirë se kur ndodhin ngricat pranverore?
- (A) Ngricat ndodhin në mëngjes herët, kur qielli është i kthjellët dhe erë pothuajse s'ka fare.
  - (B) Ngricat ndodhin në mëngjes me reshje të lehta, kur era fryn me intensitet mesatar.
  - (C) Ngricat ndodhin në mbrëmje të vona, kur ajri është i lagësht dhe temperatura bie ndjeshëm.
  - (D) Ngricat ndodhin gjatë natës me re, kur reshjet ndalojnë dhe qetësia rritet ndjeshëm.
19. Cili është shkaku më i zakonshëm i dëmtimit të pemëve frutore gjatë pranverës, sipas fragmentit?
- (A) Dëmtimet që vijnë nga insektet dhe sëmundjet e ndryshme.
  - (B) Ngricat që ndodhin në mëngjes herët gjatë stinës së pranverës.
  - (C) Reshjet e dendura të shiut dhe erërat me shpejtësi të madhe.
  - (D) Ndryshimet e shpeshta në temperatura gjatë ditëve pranverore.
20. Sipas tekstit, cilat pemë frutore janë më të ndjeshme ndaj dëmeve nga ngricat pranverore?
- (A) Boronica dhe lajthia, që rriten në vende me hije.
  - (B) Rrushi i frëngut dhe rrushi i kuq, që piqen në verë.
  - (C) Mjedra dhe lajthia, që kanë nevojë për tokë të lagësht.
  - (D) Pjeshka dhe kajsia, që lulëzojnë herët në pranverë.
21. Në krahasim me pjeshkën dhe kajsinë, çfarë tregon fragmenti për boronicat dhe lajthitë në raport me tolerancën ndaj ngricave?
- (A) Kanë të njëjtën ndjeshmëri ndaj ngricave si frutat bërthamore.
  - (B) Janë më të ndjeshme, sepse çelin më herët.
  - (C) Janë më tolerante ndaj temperaturave nën zero.
  - (D) Nuk përmenden në mënyrë specifike në tekst.
22. Cila temperaturë është kritike për dëmtimin e vezores së lules në lulëzim të plotë?
- (A) afro  $-5^{\circ}\text{C}$
  - (B)  $-1$  deri  $-2^{\circ}\text{C}$
  - (C)  $-4$  deri  $-5^{\circ}\text{C}$
  - (D) mbi  $5^{\circ}\text{C}$
23. Sipas autorit, cilat janë pasojat e një ngrice të vonshme pranverore mbi hardhinë?
- (A) Dëmtimi i frutave që janë në fazën e hershme të zhvillimit.
  - (B) Kalbja e pjesëve të nëndheshme dhe dëmtimi i trungut të fortë.
  - (C) Tharja e lastarëve të rinj dhe ndalimi i formimit të frutave.
  - (D) Ulja e aktivitetit të gjethes dhe ngadalësimi i fotosintezës.
24. Sipas fragmentit, cila nga masat mbrojtëse është më e përshtatshme dhe më e lehtë për t'u zbatuar në kushte normale fërme?
- (A) Mbulimi i çdo peme me materiale plastike për t'i izoluar nga temperaturat e ulëta.
  - (B) Rrallimi i kultivarëve që lulëzojnë herët, duke zvogëluar rrezikun e dëmtimeve nga ngrica.
  - (C) Përdorimi i sistemeve komplekse të ngrohjes për të mbrojtur sipërfaqet e mëdha të bimëve.
  - (D) Pastrimi i tokës nga barërat e padëshiruara dhe mirëmbajtja e lagështisë së saj.
25. Cila është ideja kryesore që mund të nxirret nga i gjithë teksti për ndikimin e ngricave pranverore te pemët frutore?
- (A) Ngricat pranverore janë të parëndësishme sepse bimët e forta e përballojnë lehtë këtë dukuri.
  - (B) Ngricat pranverore paraqesin rrezik sepse ndodhin në fillim të zhvillimit dhe dëmtojnë rendimentin.
  - (C) Ndikimi i ngricave varet kryesisht nga struktura e tokës dhe thellësia e rrënjëve që pemët shtriejnë.
  - (D) Vendndodhja në terrene të ulëta i mbron pemët nga pasojat e mundshme të ngricave pranverore.

**I. Read the following text carefully and answer the questions from 26-30:**

I. Today, Mike and his mom are going to the library. Mike wants a book to read, and his mom needs to use a computer there. At the library, Mike finds a book about detectives. |



II. Mike's mom sits at one of the computers in the library, checks her email and looks at pictures on the Internet. Then she reads a news article. She leaves the computer and walks holding up something out for him. Mike looks at her **quizzically**. It takes him a moment to recognize what she is holding. "I got that movie for us to watch tonight, are you ready to leave?" she asks. "Sure," Mike says, holding the movie in front of him. He is ready to check out. A librarian stands behind the counter holding an electronic scanner. "How long can we keep them?" Mike asks her. "Three weeks," says the librarian. Suddenly, Mike is surprised. His mother is checking out a large picture of the ocean. "What is that for?" Mike asks. "To put on our wall at home," she says. "You can do that?" Mike asks. "Yes, but we have to return it in three months."

26. Based on the books Mike chooses, we can tell that he is interested in \_\_\_\_\_.

- (A) science
- (B) nature
- (C) mystery
- (D) horror

27. While at the computer, Mike's mom \_\_\_\_\_.

- (A) looks for some books
- (B) checks her mail
- (C) writes a news article
- (D) makes some orders

28. Based on its use in paragraph two, it can be understood that the word **quizzically** means \_\_\_\_\_.

- (A) abnormally
- (B) indifferently
- (C) passionately
- (D) questioningly

29. As used in paragraph two, the phrase **check out** is closest in meaning to \_\_\_\_\_.

- (A) see
- (B) borrow
- (C) find
- (D) buy

30. Using the passage as a guide, it can be understood that you can check out which of the following things from the library?

- (A) Pictures
- (B) Furniture
- (C) Computers
- (D) Projectors

**II. Read the following text carefully and answer the questions from 31-36:**

I. Whether you're travelling to the islands or the mountains of Thailand, you're likely to spend at least one night in its capital city on the way.

II. The Khao San Road is a famous traveller spot, but it's noisy, not very pretty and not very Thai. For something more authentic, Phra Kanong offers an alternative place to stay, with its fantastic street markets where every day Bangkok people eat, work and live. It's not as convenient for the main tourist sites, but it has a Sky train station so you can be at the Grand Palace in 20 minutes.

III. Bangkok's traffic can be a nightmare. You can take a taxi, but there are much better ways to explore the temples and historical sites. Catch an express boat river taxi or a longtail boat along the Chao Phraya river. For the modern part of the city, the Sky train is a fast, cheap way to travel from the river to the shopping malls and nightlife of Sukhumvit, and the famous Chatuchak street market.

IV. Thai street food is among the best in the world, and for around \$5 you can eat a filling and delicious meal. Head for Chinatown – Yaowarat Street – and choose whatever looks most interesting from the many excellent Chinese and Thai restaurants and food stands.

31. What kind of text is this?

- (A) A personal letter
- (B) A travel guide
- (C) A newspaper article
- (D) A historical story

32. Most travelers spend at least one night in Bangkok because \_\_\_\_\_.

- (A) it's the cheapest city in Thailand
- (B) flights only arrive at night in Bangkok
- (C) it's on the way to other parts of Thailand
- (D) there are no hotels in other areas

33. According to paragraph two, one reason to avoid Khao San Road is because \_\_\_\_\_.

- (A) it's far from the airport
- (B) it has no restaurants
- (C) it's highly traditional
- (D) it's not enough authentic

34. As described in paragraph two, staying in Phra Kanong is convenient because \_\_\_\_\_.

- (A) it is pretty far from the Grand Palace
- (B) it has the local vibe with street markets
- (C) it is the most luxurious part of Bangkok
- (D) it is where most tourists like to stay

35. According to paragraph three, the best way to visit Bangkok's temples and historical sites is \_\_\_\_\_.

- (A) by taxi
- (B) by Skytrain
- (C) by boat
- (D) by car

36. According to paragraph four, Yaowarat Street in Bangkok is known as one of the best places for \_\_\_\_\_.
- (A) nightlife
  - (B) staying
  - (C) shopping
  - (D) eating

**III. Read the following text carefully and answer the questions from 37-43:**

I. Like many neighborhoods in large cities, Harlem has undergone **a multitude of changes**. One of the most significant in this part of New York City occurred during the early part of the twentieth century. At that time, there was a large increase in the number of African Americans who migrated **there** from the American south. They came looking for better jobs and better lives for their families. This **influx** of people, combined with a general movement towards artistic experimentation that occurred in the 1920s, formed the basis for a creative outburst of activity in all areas of the arts, a period known as the Harlem Renaissance. The period lasted from about 1919-1929, and during this time, a host of artists became celebrated. Among these were the poet Langston Hughes, jazz singers Bessie Smith and Billie Holiday, and author and civil rights leader, W.E.B. Du Bois. These artists, and many others, led the way to a revival of artistic energy among blacks and a redefinition of artistic expression.



II. Along with a celebration of arts and artistic talents, the Harlem Renaissance was intimately associated with a new expression among Blacks, one that glorified their African heritage. They were known as the "New Negroes," a term coined by the sociologist Alain Leroy Locke in 1925. This new atmosphere laid the groundwork for future civil rights activism, though it was some time before that came to the fore. In the meantime, the economic depression of the 1930s and World War II affected Harlem and were associated with a decline in this exciting period of artistic activity.

37. What is the main idea of this text?
- (A) The American South
  - (B) A major movement in Harlem
  - (C) The lives of Harlem artists
  - (D) A glorification of African-American heritage
38. Which of the following does the word **there** refer to in the first paragraph one in the phrase **who migrated there**?
- (A) The neighborhood of Harlem
  - (B) The state of New York
  - (C) The American South
  - (D) The continent of Africa
39. Which word is closest in meaning to the word **influx** in paragraph one?
- (A) Increase
  - (B) Migration
  - (C) Arrival
  - (D) Occurrence
40. According to the text, which of the following people was most likely a performer?
- (A) Bessie Smith
  - (B) Langston Hughes
  - (C) Alan Locke
  - (D) W.G.B. Dubois

41. According to the text, what were two factors that led to the Harlem Renaissance?
- (A) A revival of African energy and redefinition of self
  - (B) A large city district and an artistic atmosphere
  - (C) An increase in people and general movement towards artistic creativity
  - (D) Civil rights activism and a new atmosphere of creativity
42. According to paragraph two, the *New Negroes* were \_\_\_\_\_.
- (A) blacks who celebrated their African heritage
  - (B) blacks who were future civil rights leaders
  - (C) blacks who became community economic leaders
  - (D) blacks who fought in World War II
43. In paragraph one, the author mentions that Harlem has been through *a multitude of changes* to \_\_\_\_\_.
- (A) emphasize the importance of the immigration from the south
  - (B) introduce the topic of the Harlem Renaissance
  - (C) focus attention on economic condition leading to the depression
  - (D) set the time period in the early twentieth century

**IV. Read the following text carefully and answer the questions from 44-50:**

- I. As heart disease continues to be the number-one killer in the United States, researchers have become increasingly interested in identifying the **potential** risk factors that **trigger** heart attacks. High-fat diets and "life in the fast lane" have long been known to contribute to the high incidence of heart failure. But according to new studies, the list of risk factors may be significantly longer and quite surprising.
- II. Heart failure, for example, appears to have seasonal and temporal patterns. A higher percentage of heart attacks occur in cold weather, and more people experience heart failure on Monday than on any other day of the week. In addition, people are more susceptible to heart attacks in the first few hours after waking. Cardiologists first observed this morning phenomenon in the mid-1980s and have since discovered a number of possible causes. An early morning rise in blood pressure, heart rate, and concentration of heart-stimulating hormones, plus a reduction of blood flow to the heart, may all contribute to the higher incidence of heart attacks between the hours of 8 a.m. and 10 a.m.
- III. In other studies, both birthdays and bachelorhood have been implicated as risk factors. Statistics reveal that heart attack rates increase significantly for both females and males in the few days immediately preceding and following their birthdays. And unmarried men are more at risk for heart attacks than their married counterparts. Though stress is thought to be linked in some way to all of the aforementioned risk factors, intense research continues in the hope of further comprehending why and how heart failure is triggered.



44. What does the text mainly discuss?
- (A) Risk factors in heart attacks
  - (B) Seasonal and temporal patterns of heart attacks
  - (C) Cardiology in the 1980s
  - (D) Diet and stress as factors in heart attacks
45. In paragraph one, the word "**potential**" could best be replaced by which of the following?
- (A) Harmful
  - (B) Primary
  - (C) Unknown
  - (D) Possible

46. As used in paragraph one, the expression *life in the fast lane* means \_\_\_\_\_.
- (A) A way of life marked by a fast pace
  - (B) Driving a car in the fast lane
  - (C) A way of life marked by a slow pace
  - (D) way of life unknown to us
47. What do the second and third paragraphs of the passage mainly discuss?
- (A) The link between heart attacks and marriage
  - (B) Unusual risk factors in heart attacks
  - (C) Age and gender factors in heart attacks
  - (D) Myths about lifestyle and heart attacks
48. According to the text, which of the following is **NOT** a possible cause of many heart attacks?
- (A) Decreased blood flow to the heart
  - (B) Increased blood pressure
  - (C) Increase in hormones
  - (D) Lower heart rate
49. Which of the following is **NOT** cited as a possible risk factor?
- (A) Having a birthday
  - (B) Getting married
  - (C) Eating fatty foods
  - (D) Being under stress
50. Which of the following can be inferred from the text?
- (A) We now fully understand how risk factors trigger heart attacks.
  - (B) We recently began to study how risk factors trigger heart attacks.
  - (C) We have not identified many risk factors associated with heart attacks.
  - (D) We do not fully understand how risk factors trigger heart attacks.

51. Nëse brinja  $a$  e katrorit rritet për 1 cm, atëherë syprina e katrorit rritet për  $21\text{cm}^2$ . Sa ka qenë brinja  $a$  para rritjes?
- (A)  $a = 7\text{ cm}$
  - (B)  $a = 8\text{ cm}$
  - (C)  $a = 9\text{ cm}$
  - (D)  $a = 10\text{ cm}$
52. Një kompani prodhon artikuj  $x$ , me kosto  $C(x) = 5x + 200$  dhe i shet me çmimin  $S(x) = 10x$ , ku  $x$  është sasia e artikujve të shitur. Për çfarë sasive të artikujve të shitur, kjo kompani fillon të ketë fitim?
- (A) Më shumë se 40 artikuj
  - (B) Më pak se 30 artikuj
  - (C) Fiks 35 artikuj
  - (D) Fiks 20 artikuj
53. Cila nga bashkësitë e dhëna është e pafundme?
- (A)  $\{1, 2, \dots, 1000\}$
  - (B)  $\{x \in \mathbb{Z} : 0 < x < 99\}$
  - (C)  $\{x \in \mathbb{Q} : -1 < x < 1\}$
  - (D)  $\{x \in \mathbb{N} : x^2 = -4\}$
54. Le të jenë 2,  $x$ ,  $y$ ,  $z$  katër termat e parë të një vargu aritmetik. Sa është vlera e shprehjes  $x + y - z$ ?
- (A) 0
  - (B) 2
  - (C) 4
  - (D) 6
55. Pas thjeshtimit të shprehjes  $\frac{3x^2 - 12}{x - 2}$  fitohet
- (A)  $3x$
  - (B)  $x + 4$
  - (C)  $3(x + 2)$
  - (D)  $3x - 6$
56. Cili është ekuacioni i drejtëzës e cila është normale me drejtëzën e dhënë me  $y = -3x + 2$ ?
- (A)  $y = \frac{1}{3}x + 1$
  - (B)  $y = 2 - 3x$
  - (C)  $y = -\frac{1}{3}x$
  - (D)  $y = -3x$
57. Një dritare ka formë të sektorit rrethor, me rreze  $r = 60\text{ cm}$  dhe kënd qendror  $\alpha = 120^\circ$ . Sa është syprina e sipërfaqes së dritares?
- (A)  $S = 450\pi\text{ cm}^2$
  - (B)  $S = 600\pi\text{ cm}^2$
  - (C)  $S = 1200\pi\text{ cm}^2$
  - (D)  $S = 1500\pi\text{ cm}^2$

58. Sa është vlera e shprehjes  $\sqrt{50} + \sqrt{8}$  ?


- (A)  $\sqrt{98}$
- (B)  $\sqrt{75}$
- (C)  $\sqrt{62}$
- (D)  $\sqrt{58}$

59. Nëse  $x$  është zgjidhja e ekuacionit  $2^x + 2^x + 2^x = 48$  sa është  $3^x$  ?

- (A) 3
- (B) 4
- (C) 27
- (D) 81

60. Le të jetë  $M$  mesi i segmentit  $SU$ . Sa është gjatësia e segmentit  $SU$  ?

- (A) 70
- (B) 75
- (C) 80
- (D) 85



61. Një dron fluturon në një trajektore parabolike  $h(t) = -5t^2 + 20t$ . Sa është lartësia maksimale e fluturimit të tij?

- (A) 10 m
- (B) 20 m
- (C) 25 m
- (D) 30 m

62. Paga e një punëtori është rritur nga 550 euro në 660 euro. Sa % është rritur paga?

- (A) 12%
- (B) 15%
- (C) 18%
- (D) 20%

63. Për funksionin  $f(x) = ax^2 + 24$  ku  $a$  është konstante vlen  $f(4) = 8$ . Sa është  $f(-4)$  ?





- (A) 8
- (B) -8
- (C) -1
- (D) 0

64. Sa është  $\lim_{x \rightarrow 1} \frac{1-x^3}{1-x^6}$  ?

- (A) 0
- (B)  $\frac{1}{3}$
- (C)  $\frac{1}{2}$
- (D) 2

65. Në cilin nga rastet vlen  $\vec{a} + \vec{c} = \vec{b}$  ?

- (A) Figura A
- (B) Figura B
- (C) Figura C
- (D) Figura D



66. Janë dhënë numrat kompleksë:  $z_1 = 3 - i$  dhe  $z_2 = -1 + 2i$ . Sa është moduli i numrit  $z_1 + z_2$  ?

- (A)  $|z_1 + z_2| = \sqrt{5}$
- (B)  $|z_1 + z_2| = \sqrt{3}$
- (C)  $|z_1 + z_2| = 1$
- (D)  $|z_1 + z_2| = 2$

67. Sa është derivati i funksionit  $f(x) = \frac{x^2 - 3x}{2}$  në pikën  $x_0 = 4$  ?

- (A) 2
- (B)  $\frac{5}{2}$
- (C)  $\frac{2}{5}$
- (D)  $\frac{3}{2}$

68. Një grup shokësh duan të organizojnë një piknik në muajin Qershor, në njërën nga datat që do zgjidhet rastësisht. Sa është gjasa (probabiliteti) që data e përzgjedhur të përmbajë shifrën 1?

- (A)  $\frac{1}{6}$
- (B)  $\frac{1}{3}$
- (C)  $\frac{2}{5}$
- (D)  $\frac{1}{5}$

### Qershor

| Hë | Ma | Më | En | Pr | Sht | Di |
|----|----|----|----|----|-----|----|
|    |    |    |    |    |     | 1  |
| 2  | 3  | 4  | 5  | 6  | 7   | 8  |
| 9  | 10 | 11 | 12 | 13 | 14  | 15 |
| 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21  | 22 |
| 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28  | 29 |
| 30 |    |    |    |    |     |    |

69. Një komision ka përzgjedhur fillimisht 10 maturantë finalistë për një program ndërkombëtar të shkëmbimit të nxënësve. Prej tyre duhet të përzgjedhen 4 për të udhëtuar, pa rëndësi të renditjes së përzgjedhjes. Sa mënyra të ndryshme të përzgjedhjes ka?

- (A) 40
- (B) 80
- (C) 110
- (D) 210

70. Shuma e dy numrave është 14, ndërsa trefishi njërit prej tyre është sa gjysma e numrit tjetër. Cilët janë ata numra?

- (A) 1, 13
- (B) 5, 9
- (C) 2, 12
- (D) 6, 8

71. Tabela tregon numrin e librave që kanë lexuar një grup nxënësish.

|               |    |   |   |   |   |   |
|---------------|----|---|---|---|---|---|
| Nr. i librave | 1  | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
| Frekuenca     | 10 | 3 | 5 | 2 | 6 | 4 |

Sa nxënës kanë lexuar më pak se pesë libra?


- (A) 13
- (B) 20
- (C) 17
- (D) 15

72. Një popullsi insektesh me numër fillestar prej  $P_0$  individësh, dyfishohet për 5 ditë. Cili është modeli matematikor i shtimit të kësaj popullsie në varësi të kohës  $t$ , të shprehur në ditë?

- (A)  $P(t) = P_0 \cdot 2^{\frac{t}{5}}$
- (B)  $P(t) = P_0 \cdot 2^{5t}$
- (C)  $P(t) = 5 \cdot P_0^{2t}$
- (D)  $P(t) = 2 \cdot P_0^{5t}$

73. Sa është vëllimi i trupit të dhënë në figurë?

- (A)  $1400(\pi + 6) \text{ m}^3$
- (B)  $1600(\pi + 6) \text{ m}^3$
- (C)  $1800(\pi + 6) \text{ m}^3$
- (D)  $2000(\pi + 6) \text{ m}^3$



74. Shqyrtojmë fjalitë vijuese:

$p$ : Ambra është e lumtur

$q$ : Ambra luan piano

$r$ : Lumi është i lumtur

Shqyrtojmë tani gjykimin

$f$ : Nëse Ambra është e lumtur ose luan piano atëherë Lumi nuk është i lumtur.

Cila formulë e shpreh gjykimin  $f$ ?

- (A)  $\neg r \vee p \wedge q$
- (B)  $p \vee q \Rightarrow \neg r$
- (C)  $\neg r \Rightarrow p \wedge q$
- (D)  $p \vee q \wedge \neg r$

75. Të caktohet qendra dhe rrezja e rrethit të dhënë me ekuacionin  $x^2 + y^2 - 16x - 17 = 0$ .

- (A)  $Q(0,2), r = 6$
- (B)  $Q(2,2), r = 7$
- (C)  $Q(4,2), r = 8$
- (D)  $Q(8,0), r = 9$

76. Cila nga këto madhësi fizike është madhësi vektoriale?

- (A) Temperatura
- (B) Shpejtësia
- (C) Koha
- (D) Masa

77. Bazuar në shprehjen për punë mekanike  $A = F \cdot s \cdot \cos\alpha$ , në cilin nga rastet si në tabelë, kryhet punë maksimale?

- (A) IV
- (B) III
- (C) II
- (D) I

| Rastet | Këndi $\alpha$ |
|--------|----------------|
| I      | $0^\circ$      |
| II     | $45^\circ$     |
| III    | $60^\circ$     |
| IV     | $90^\circ$     |


78. Pse një peshk qëndron në të njëjtën thellësi në ujë pa lëvizur?



- (A) Sepse forca e shtytjes është e barabartë me peshën e tij
- (B) Sepse forca e gravitetit është më e madhe se forca e shtytjes
- (C) Sepse uji nuk ushtron me asnjë forcë mbi të
- (D) Sepse pesha e tij është zero në ujë


79. Cila nga formulat paraqet forcën magnetike që vepron në një përçues të drejtë me rrymë në fushën magnetike?

- (A)  $F = B \cdot I \cdot l \cdot \tan \vartheta$
- (B)  $F = B \cdot I \cdot l \cdot \text{ctg} \vartheta$
- (C)  $F = B \cdot I \cdot l \cdot \cos \vartheta$
- (D)  $F = B \cdot I \cdot l \cdot \sin \vartheta$




80. Në figurë janë paraqitur katër (IV) distanca të ndryshme të objektit (O) ndaj thjerrrës konvergjente. Bazuar në distancat e shëmbëllimit (SH) ndaj thjerrrës, në cilin rast objekti është i vendosur pambarimisht larg thjerrrës?

- (A) I
- (B) II
- (C) III
- (D) IV



81. Në figurë janë paraqitur pozitat momentale të katër planetëve ndaj diellit. Sipas ligjit të tretë të Keplerit, cili nga planetët e ka periodën e rrotullimit  $T$  më të madhe?

- (A) I
- (B) II
- (C) III
- (D) IV




82. Me çfarë nxitimi  $a$  lëvizë saja, me masë  $m = 3kg$ , nëse Ceni e tërheq atë me forcë  $F = 6N$  ?

- (A)  $a = 18 \frac{m}{s^2}$
- (B)  $a = 6 \frac{m}{s^2}$
- (C)  $a = 3 \frac{m}{s^2}$
- (D)  $a = 2 \frac{m}{s^2}$




83. Ani me masë  $m_1 = 30kg$  dhe Ana me masë  $m_2$  janë ulur në trarin lëvizës (lloz) si në figurë. Nëse distancat e pozitive të Anit dhe Anës nga qendra e trarit janë si në figurë, atëherë sa duhet të jetë masa e Anës  $m_2$ , ashtu që trari të jetë në ekuilibër?

- (A)  $m_2 = 36kg$
- (B)  $m_2 = 30kg$
- (C)  $m_2 = 24kg$
- (D)  $m_2 = 15kg$



84. Trupit hedhet nga një lartësi  $y$  në drejtimin horizontal me shpejtësi fillestare  $v_{0x} = 25 \frac{m}{s}$ . Pas sa kohe  $t$  trupi bie në sipërfaqe horizontale në distancën  $x = 50m$  ?

- (A)  $t = 50s$
- (B)  $t = 25s$
- (C)  $t = 2s$
- (D)  $t = 0.5s$



85. Për sa ndryshon energjia e brendshme  $\Delta U$  e një gazi të mbyllur me piston të palëvizshëm, kur ai nxehet me burim nxehtësie  $Q = 15J$  ?

- (A)  $\Delta U = 1500J$
- (B)  $\Delta U = 150J$
- (C)  $\Delta U = 15J$
- (D)  $\Delta U = 1.5J$




86. Nëse lavjerrësi matematik ka periodën e lëkundjes  $T = 3$  s, atëherë sa duhet të jetë gjatësia e perit për të arritur këtë periodë, nëse nxitimi i gravitetit e ka vlerën  $g = 9.81 \text{ m/s}^2$  ?

- (A)  $l = 2.23\text{m}$
- (B)  $l = 3.27\text{m}$
- (C)  $l = 12.81\text{m}$
- (D)  $l = 29.43\text{m}$

87. Çfarë frekuence  $\nu'$  të zërit të autoambulancës dëgjon Zani, nëse autoambulanca lëviz me shpejtësi  $v_b = 100 \frac{\text{m}}{\text{s}}$


dhe me këtë rast emiton frekuencë  $\nu = 80\text{Hz}$  ? Shpejtësia e përhapjes së zërit në ajër është  $v = 340 \frac{\text{m}}{\text{s}}$ .

- (A)  $100\text{Hz}$
- (B)  $80\text{Hz}$
- (C)  $62\text{Hz}$
- (D)  $6.2\text{Hz}$




88. Sa është intensiteti i fushës magnetike të solenoidit si në figurë? Konstanta e permeabilitetit të vakumit le të merret  $\mu_0 = 12.57 \cdot 10^{-7} \frac{\text{H}}{\text{M}}$

- (A)  $B = 31425 \cdot 10^{-7}\text{T}$
- (B)  $B = 3142.5 \cdot 10^{-7}\text{T}$
- (C)  $B = 314.25 \cdot 10^{-7}\text{T}$
- (D)  $B = 31.425 \cdot 10^{-7}\text{T}$




89. Një transformator ka një bobinë primare dhe sekondare. Nëse në bobinën primare (Bp) ka  $N_1 = 8000$  dredha dhe ka një tension prej  $U_1 = 480$  V, kurse tensioni në bobinën sekondare (Bs) është  $U_2 = 120$  V, atëherë sa dredha duhet të ketë bobina sekondare  $N_2$  ?

- (A) 2000 dredha
- (B) 4000 dredha
- (C) 6000 dredha
- (D) 8000 dredha




90. Sa duhet të jetë energjia rrezatuese e fotonit  $h\nu$  në sipërfaqe të kaliumit, ashtu që nga sipërfaqja e tij të emitohet elektroni me energji kinetike  $E_k = 0.2\text{eV}$  ndërsa puna e daljes së elektronit nga kaliumi është  $A = 2\text{eV}$  ?

- (A)  $4.2\text{eV}$
- (B)  $2.2\text{eV}$
- (C)  $2\text{eV}$
- (D)  $0.2\text{eV}$



91. Izotopi i **Cesium-137** ka një gjysmë jetë prej 30 vitesh. Nëse kemi një mostër me 1000 atome Cesium-137, sa atome mbeten pas 60 viteve?


- (A) 1000 atome
- (B) 500 atome
- (C) 250 atome
- (D) 150 atome



92. Katër makina A, B, C dhe D lëvizin në një rrugë drejtvizore. Grafikët e distancës së tyre ndaj kohës janë paraqitur në figurë.


Cila nga këto makina është më e ngadalshme?

- (A) Makina D
- (B) Makina C
- (C) Makina B
- (D) Makina A



93. Sa është rendimenti i një makine termike sipas të dhënave në figurë?


- (A)  $\eta = \frac{T_2 - T_1}{T_1} = -0,5$
- (B)  $\eta = \frac{T_1 - T_2}{T_1} = 0,5$
- (C)  $\eta = \frac{T_2 + T_1}{T_2} = 3$
- (D)  $\eta = \frac{T_2 + T_1}{T_1} = 1,5$



94. Në figurë janë paraqitur dy situata *a* dhe *b* të ndryshme të patinazhistes së njëjtë. Duke i analizuar situatat, cili nga rreshtat për momentin e inercionit  $I$  ( $kgm^2$ ) dhe shpejtësinë këndore  $\omega$  ( $s^{-1}$ ) është i saktë ?


- (A) I
- (B) II
- (C) III
- (D) IV

| Rreshti | Rasti <i>a</i> | Rasti <i>b</i>   |
|---------|----------------|------------------|
| I       | $I$ e madhe    | $\omega$ e vogël |
| II      | $I$ e vogël    | $\omega$ e madhe |
| III     | $I$ e madhe    | $\omega$ e madhe |
| IV      | $I$ e vogël    | $\omega$ e vogël |



95. Në figurë janë paraqitur qarku elektrik (figura *a*) dhe qarku i rrjedhjes së ujit (figura *b*). Duke analizuar me kujdes pjesët përbërëse të qarqeve, cili është analogu i llambës elektrike në qarkun e rrjedhjes së ujit?

- (A) 4
- (B) 3
- (C) 2
- (D) 1



96. Në figurë është paraqitur një lugë e vendosur në gotën me ujë, bishti i së cilës është shënuar me I. Në këtë figurë mund të vërehet efekti i thyerjes dhe reflektimit të dritës. Duke analizuar me kujdes, me cilin numër është shënuar efekti i thyerjes së dritës?


- (A) I
- (B) II
- (C) III
- (D) IV



97. Në figurë është paraqitur rrezatimi termik i Diellit në Tokë.


Sa është gjatësia valore maksimale  $\lambda_{MAX} = ?$  e cila arrin në Tokë, nëse konstantja e Vinit ka vlerë ( $b = 2,88 \cdot 10^{-3} m \cdot K$ )?

- (A)  $\lambda_{MAX} = 6 \cdot 10^{-6} m$
- (B)  $\lambda_{MAX} = 2,88 \cdot 10^{-6} m$
- (C)  $\lambda_{MAX} = 0,24 \cdot 10^{-6} m$
- (D)  $\lambda_{MAX} = 0,48 \cdot 10^{-6} m$




98. Në diagram është paraqitur lëvizje e ndryshueshme e një trupi.

Sipas të dhënave të paraqitura në diagram në cilat pjesë të trajektorës nxitimi gjatë lëvizjes është zero?



- (A) Segmenti OA dhe AB
- (B) Segmenti AB dhe DE
- (C) Segmenti AB dhe CD
- (D) Segmenti BC dhe CD

99. Duke e analizuar figurën cili nga pohimet e shënuara është i saktë?



- (A) Tensioni ndryshon nëpër secilën rezistencë
- (B) Tensioni është i njëjtë në të gjitha rezistencat
- (C) Intensiteti i rrymës është i njëjtë në secilën rezistencë
- (D) Intensiteti i rrymës ndahet në mënyrë të barabartë në tri rezistencat


100. Çfarë ndodh me masën e një objekti kur ai lëviz me shpejtësi të afërt me shpejtësinë e dritës?

- (A) Masa e tij rritet
- (B) Masa e tij bëhet zero
- (C) Masa e tij zvogëlohet
- (D) Masa e tij mbetet e pandryshuar


76. Cila nga figurat e mëposhtme paraqet një ndryshim kimik të substancës?



1. Ndarja e etanolit nga uji



2. Ndarja e vajit nga uji



3. Shkrirja e akullit



4. Ndezja e qiriut


- (A) Figura 1
- (B) Figura 2
- (C) Figura 3
- (D) Figura 4

77. Kobalti me masë atomike **58.933** është renditur në tabelën e sistemit periodik para nikelit me masë atomike **58.693**. Pse kobalti (Co) është renditur para nikelit (Ni) në tabelën e sistemit periodik të elementeve?

- (A) Nikeli ka më pak elektrone
- (B) Nikeli ka një proton më shumë
- (C) Kobalti është zbuluar i pari
- (D) Kobalti ka dendësitë më të ulët

78. Një komponim organik është paraqitur me formulën strukturore vijuese. Cila është formula empirike e këtij komponimi?

- (A)  $\text{CH}_2\text{O}$
- (B)  $\text{CH}_6\text{O}_3$
- (C)  $\text{C}_2\text{H}_4\text{O}_2$
- (D)  $\text{C}_3\text{H}_6\text{O}_3$




79. Nëse 128 gram dioksid të sulfurit ( $\text{SO}_2$ ) bashkëveprojnë me sasi të mjaftueshme të oksigjenit përftohen 120 gram treoksid të sulfurit ( $\text{SO}_3$ ). Sa është rendimenti i reaksionit?

Nëse janë dhënë:  $\text{Ar}(\text{S})=32$ ,  $\text{Ar}(\text{O})=16$

- (A) 90 %
- (B) 85 %
- (C) 80 %
- (D) 75 %


80. Në cilin rast janë paraqitur të dhënat e sakta për tetraklormetanin ( $\text{CCl}_4$ )?

|     | Lidhjet kimike | Lloji i molekulës |
|-----|----------------|-------------------|
| I   | Polare         | Polare            |
| II  | Jopolare       | Polare            |
| III | Polare         | Jopolare          |
| IV  | Jopolare       | Jopolare          |



- (A) IV
- (B) III
- (C) I
- (D) II

81. Gjatë djegies së natriumit metalik në klor të gaztë, reaksioni kimik zhvillohet nëpër disa faza, të cilat paraqiten me ciklin e Born-Haberit.



Cila nga fazat e përmendura paraqet proces ekzotermik?

- (A) Entalpia e rritit kristalor ( $\Delta H_{\text{rrj}}$ )
- (B) Entalpia e jonizimit të natriumit atomik ( $\Delta H_j$ )
- (C) Entalpia e sublimimit të natriumit metalik ( $\Delta H_{\text{sub}}$ )
- (D) Entalpia e disocimit të molekulës së klorit ( $\Delta H_{\text{dis}}$ )


82. Rendi i reaksionit është madhësi e cila matet në mënyrë ekesperimentale dhe përcakton shpejtësinë e reaksioneve kimike. Si do të ndryshoj shpejtësia në reaksionet e rendit të dytë, nëse vëllimi i enës reaguese zvogëlohet për 3 herë?

- (A) Shpejtësia e reaksionit zvogëlohet për 3 herë
- (B) Shpejtësia e reaksionit zvogëlohet për 9 herë
- (C) Shpejtësia e reaksionit rritet për 3 herë
- (D) Shpejtësia e reaksionit rritet për 9 herë

83. Cili është përqendrimi i tretësirës së NaOH nëse 50 mL të kësaj tretësire me përqendrim 1.0 M janë holluar me ujë deri në 200 mL?

- (A) 0.25 M
- (B) 0.50 M
- (C) 0.75 M
- (D) 1.0 M


84. Gjatë përzierjes së dy substancave të ndryshme zhvillohet reaksioni vijues:



Cila nga substancat e paraqitura më lartë paraqet bazën e konjuguar sipas Bronsted-Lowrit?

- (A)  $\text{NH}_4^+$
- (B)  $\text{NH}_3$
- (C)  $\text{HCO}_3^-$
- (D)  $\text{CO}_3^{2-}$

85. Një substancë kimike jonike kur vendoset në ujë fillon tretja e saj, dhe pas një kohe të caktuar arrihet drejtpeshimi kimik, sepse numri i molekulave që treten barazohet me numrin e molekulave që formohen. Sa është tretshmëria molare e sulfurës së zinkut?  $K_{PT}(ZnS)=1.6 \cdot 10^{-23} \text{ mol}^2/\text{dm}^6$




- (A)  $T=3.2 \cdot 10^{-46} \text{ mol}/\text{dm}^3$
- (B)  $T=8.0 \cdot 10^{-20} \text{ mol}/\text{dm}^3$
- (C)  $T=4.0 \cdot 10^{-12} \text{ mol}/\text{dm}^3$
- (D)  $T=2.5 \cdot 10^{-8} \text{ mol}/\text{dm}^3$

86. Shuma algjebrike e numrave oksidues të elementeve të një molekulë është e barabartë me zero. Ndërsa të jonet, shuma algjebrike e elementeve është e barabartë me ngarkesën e jonit. Sa është numri oksidues i sulfurit të joni sulfat  $SO_4^{2-}$  ?

- (A) + 2
- (B) + 4
- (C) + 6
- (D) + 8

87. Elektroda standarde e hidrogjenit e paraqitur në figurë, përbëhet nga një elektrodë platini (e veshur me një shtresë platini të grimcuar imët për të rritur sipërfaqen e kontaktit) e zhytur në tretësirë acidi me përqendrim **1M** të joneve  $H^+$ . Mbi elektrodë gurgullohet hidrogjeni i gaztë me tryzni **1 atm**. Cili është qëllimi i përdorimit të elektrodës së hidrogjenit në një element galvanik?

- (A) Për të matur shtypjen që bënë gazi i hidrogjenit
- (B) Për të mbajtur rrymën konstante në elementin galvanik
- (C) Për ta mbrojtur elektrodën e platinës nga oksidimi me acid
- (D) Për të krahasuar potencialet standarde të elektrodave të tjera




88. Një nxënës i gjimnazit shkencor po analizon vetitë kimike të metaleve alkaline duke vëzhguar veprimin e natriumit me ujë. Ai vëren që gjatë këtij reaksioni ndodhin dy procese kryesore: prodhimi i një gazi dhe lirimi i *nxehhtësisë*. Cilat produkte formohen në këtë reaksion kimik?

- (A) Gjatë këtij reaksioni formohet hidroksidi i natriumit dhe hidrogjeni
- (B) Gjatë këtij reaksioni formohet oksidi i natriumit dhe oksigjeni
- (C) Gjatë këtij reaksioni formohet peroksidi i natriumit dhe hidrogjeni
- (D) Gjatë këtij reaksioni formohet hidroksidi i natriumit dhe oksigjen

89. Një element i grupit 15 me *veti jometalike* në temperaturë dhome paraqitet si *molekulë katëratomike*. Cili është ky element kimik?

- (A) Azoti
- (B) Fosfori
- (C) Squfuri
- (D) Arseni

90. Ozoni formohet nga oksigjeni në shtresat e larta atmosferike të Tokës, nën veprimin e rrezatimit ultravjollcë, dhe shërben si pengesë për depërtimin e rrezatimit të dëmshëm UV në sipërfaqen e Tokës. Mirëpo përdorimi i disa substancave kimike ndikon që të dëmtohet shtresa ozonike dhe të krijohen vrima që lejojnë depërtimin e rrezatimit të dëmshëm në Tokë. Cili nga proceset e përmendura e dëmton shtresën ozonike?



- (A) Hidrokarburet lirojnë hidrogjen atomik ( $H^*$ ) që me ozonin formon reaksione vargore dhe liron oksigjen
- (B) Hidrokarburet lirojnë hidrogjen molekular ( $H_2$ ) që me ozonin formon reaksione vargore dhe liron oksigjen
- (C) Karbonfluorokloruret lirojnë molekula të klorit ( $Cl_2$ ) që me ozon zhvillojnë reaksione vargore
- (D) Klorfluorhidrokarburet lirojnë radikale të klorit ( $Cl^*$ ) që me ozon zhvillojnë reaksione vargore

91. Një pacient ka vizituar mjekun për shkak të anemisë dhe gjithashtu ka pasur probleme me koagulimin e gjakut. Mjeku ka rekomanduar përdorimin e një substance kimike për të ndihmuar në trajtimin e këtyre problemeve shëndetësore.




Cila substancë përdoret në këtë rast?

- (A)  $CaSO_4 \cdot 2 H_2O$
- (B)  $CuSO_4 \cdot 5 H_2O$
- (C)  $FeCl_3 \cdot 6 H_2O$
- (D)  $MgSO_4 \cdot 7 H_2O$

92. Një inxhinier ndërtimi po punon në një projekt ku është e nevojshme të përdoren materiale lidhëse që mund të ngurtësohen edhe në prani të ujit. Ai ka zgjedhur një material që është pjesë e grupeve të materialeve hidraulike. Cilin material ka përdorur inxhinieri në këtë rast?

- (A) Gipsin
- (B) Çimenton
- (C) Gelqeren
- (D) Qeramikën


93. Formulatat hapësinore (stereokimike) tregojnë radhitjen dhe orientimin hapësinor të atomeve apo grupeve atomike në molekulë, dhe zakonisht paraqiten me modele të ndryshme molekulare. Cili është emri i komponimit kimik të paraqitur me formulën skeletore në vijim?




- (A) Cis-buteni-2
- (B) Cis-penteni-2
- (C) Trans-buteni-2
- (D) Trans-penteni-2

94. Një kimist po analizonte alkanet dhe vëren se, për shkak të izomerisë së vargur, tek ato paraqiten lloje të ndryshme të atomeve të karbonit në strukturën e tyre. Për cilin lloj të atomit të karbonit është i lidhur hidrogjeni i treguar me shigjetë?

- (A) Karbonin primar
- (B) Karbonin sekondar
- (C) Karbonin kuaternar
- (D) Karbonin terciar




95. Në cilin grup të alkooleve bën pjesë komponimi organik i paraqitur në figurë?



- (A) Alkoole primare
- (B) Alkoole sekondare
- (C) Alkoole terciare
- (D) Alkoole të pangopura


96. Reaksione karakteristike për alkil halogjeruret janë edhe reaksionit e eliminimit. Në qoftë se alkil halogjenuri është josimetrik, me eliminim mund të formohen dy lloj alkenesh, siç është paraqitur në reaksionin në vijim.



Pse metil-2-buten-2 është fituar në sasi më të madhe?

- (A) Sepse përmban numër më të madh të zëvendësuesëve në lidhjen dyfishe
- (B) Sepse përmban numër më të vogël të zëvendësuesëve në lidhjen dyfishe
- (C) Sepse përmban numër më të madh të lidhjeve pi dhe sigma
- (D) Sepse përmban numër më të vogël të lidhjeve pi dhe sigma

97. Alkil halogjenuret i nënshtrohen reaksioneve të hidrolizës bazike, ku si produkte formohen alkoolet korresponduese të tyre. Mekanizmi i hidrolizës së një halogjenalkani paraqitet në figurën vijuese.



Cili lloj i reaksionit kimik është paraqitur në këtë figurë?

- (A) Reaksioni i substituimit (zëvendësimit) elektrofil monomolekular
- (B) Reaksioni i substituimit (zëvendësimit) nukleofil monomolekular
- (C) Reaksioni i substituimit (zëvendësimit) elektrofil bimolekular
- (D) Reaksioni i substituimit (zëvendësimit) nukleofil bimolekular

98. Esteret janë komponime që formohen nga reaksioni i bashkëveprimit të një acidi karboksilik me një alkool. Pse përdoret një tepriçë acidi në sintezën e etil butanoatit, i cili është përgjegjës për aromën e ananasit?

- (A) Për të zhvendosur ekuilibrin drejt formimit të esterit
- (B) Për të shpejtuar hidrolizën e etil butanoatit
- (C) Për të zvogëluar përqendrimin e esterit
- (D) Për të penguar formimin e esterit



99. Një kimist po kryente një eksperiment në të cilin kloroetani reagon me amoniak, siç është treguar në vijim.



Cili komponim organik është fituar gjatë këtij eksperimenti?

- (A) Nitroetani
- (B) Aminoetani
- (C) Kloruri vinilik
- (D) Kloruri i etilamonit

100. Një këmishë si kjo e paraqitur në foto është e punuar nga materiali i cili përmbanë më tepër se 70% të aminoacideve si glycinë, alaninë dhe serinë. Si quhet ky material i cili bënë pjesë në grupin e polimerëve natyrorë?


- (A) Pambuk
- (B) Najlon 6,6
- (C) Mëndafsh
- (D) Polistiren



76. Gjatë vëzhgimit të një qelize me mikroskop, Ani ka identifikuar një organele, siç tregohet në figurë. Kjo organele është e rrethuar me dy membrana, përmban ADN dhe është përgjegjëse për prodhimin e energjisë në qelizë.

Cilin prej organeleve të shënuar më poshtë ka vërejtur Ani?

- (A) Bërthamën
- (B) Kloroplastin
- (C) Mitokondrinë
- (D) Ribozomin



77. Karbohidratet janë komponime organike që gjenden në të gjithë organizmat e gjallë dhe krijohen gjatë procesit të fotosintezës. Cili është roli kryesor i karbohidrateve në organizmat e gjallë?

- (A) Sigurimi i energjisë për organizmin
- (B) Ruajtja e informacionit gjenetik
- (C) Rregullimi i reaksioneve kimike
- (D) Mbrojtja e qelizave nga infeksionet

78. Membrana qelizore mbështjell qelizën dhe e ndan atë nga qelizat e tjera ose nga mjedisi i jashtëm. Ajo është kryesisht e përbërë nga lipidet dhe proteinat. Çfarë i mundëson membranës struktura lipo-proteinike?

- (A) Riprodhimin dhe rritjen e qelizave
- (B) Komunikimin dhe bartjen e informacionit gjenetik
- (C) Prodhimin e energjisë dhe zbërthimin e materieve organike
- (D) Kontrollin e shkëmbimit të lëndëve dhe ruajtjen e ekuilibrit osmotik të qelizës

79. Qelizat, në varësi të mënyrës së shpërndarjes së materialit gjenetik në citoplazmë, mund të jenë prokariote ose eukariote. Çfarë i karakterizon qelizat eukariote?

- (A) Prania e bërthamës së vërtetë me membranë
- (B) Prania e bërthamës jo të vërtetë dhe me bërthamëz
- (C) Prania e bërthamës jo të vërtetë dhe pa membranë
- (D) Prania e masës bërthamore pa material gjenetik të përzier me citoplazmën

80. Lura në orën e biologjisë ka prezentuar disa organe bimore si në figurë.


Cilit grup të bimëve u takojnë këto struktura të bimëve?

- (A) Fiermave
- (B) Myshqeve
- (C) Dikotiledoneve
- (D) Monokotiledoneve




81. Shumimi i organizmave është shumë i rëndësishëm pasi që e siguron vazhdimësinë e jetës. Cili tip i fekondimit dhe i zhvillimit është paraqitur në figurën e mëposhtme?

- (A) Fekondim i brendshëm, zhvillim i brendshëm
- (B) Fekondim i jashtëm, zhvillim i jashtëm
- (C) Fekondim i jashtëm, zhvillim i brendshëm
- (D) Fekondim i brendshëm, zhvillim i jashtëm



82. Në bazë të karakteristikave morfologjike të organizmit të paraqitur në figurë, në cilin grup sistematik të shtazëve bënë pjesë ky organizëm?

- (A) Butakë
- (B) Sfungjerë
- (C) Përcëllues
- (D) Këmbësegmentuar




83. Në grupin e zvarranikëve bëjnë pjesë lloje të ndryshme që sipas ngjashmërive të tyre, grupohen në katër rende. Cili prej këtyre grupeve të zvarranikëve e kanë trupin të mbuluar me karapaks?

- (A) Breshkat
- (B) Hateriet
- (C) Krokodilët
- (D) Squamatat

84. Plasmodium vivax është një protist që paraziton te njeriu dhe shkakton sëmundje. Infektimi me këtë parazit bëhet përmes thumbimit të mushkonjës të gjinisë Anopheles. Cilën sëmundje e shkakton Plasmodium vivax?

- (A) Kolerën
- (B) Malarien
- (C) Dizenterinë
- (D) Tuberkulozin




85. Sëmundjet transmetohen përmes rrugëve të ndryshme, si: përmes ajrit, ushqimit, kontaktit fizik dhe kontaktit seksual. Cila nga sëmundjet e mëposhtme është seksualisht e transmetueshme?

- (A) Gripi
- (B) Diabeti
- (C) Klamidia
- (D) Astma

86. Olta gjatë prezantimit në orën e biologjisë ka paraqitur diagramin e një procesi metabolik që ndodh në qelizë. Cili proces metabolik është zhvilluar në këtë rast?

- (A) Frymëmarrja aerobe
- (B) Frymëmarrja anaerobe
- (C) Glukoneogjeneza
- (D) Fotosinteza



87. Metabolizmi përfshin të gjitha proceset biokimike të cilat zhvillohen në protoplazmë të qelizës. Cili nga proceset e shënuara më poshtë bën pjesë në grupin e proceseve anabolike?
- (A) Fotosinteza si proces ekzoenergjetik  
 (B) Fotosinteza si proces endoenergjetik  
 (C) Frymëmarrja qelizore  
 (D) Cikli pentozik
88. Kur qelizës i duhet proteina e caktuar, atëherë fillon bartja e informatës gjenetike prej segmentit të caktuar të ADN-së ose gjenit në kopje të  $ARN_i$ . Si quhet etapa e parë e bartjes së informatës gjenetike nga ADN në  $ARN_i$ ?
- (A) Replikim  
 (B) Translatim  
 (C) Transkriptim  
 (D) Translokacion
89. Nëse kryqëzojmë dy bimë të bizeles me ngjyrë të kuqe, të cilat kanë gjenotipin heterozigot "Aa", në cilin rast shfaqet ngjyra e bardhë e lules, që është tipar recesiv dhe shënohet me "a" ?
- (A) Shfaqet në formë kodominante  
 (B) Shfaqet kur dy alelet janë mbizotëruese  
 (C) Shfaqet kur dy alelet janë recesive  
 (D) Shfaqet kur është i pranishëm një alel tjetër mbizotërues
90. Hemofilia është një sëmundje trashëguese recesive që ndikon në uljen e aftësisë së mpiksjes së gjakut. Me cilin kromozom është e lidhur trashëgimia e hemofilisë?
- (A) Kromozomin Y  
 (B) Kromozomin X  
 (C) Kromozomin 21  
 (D) Kromozomin 18



91. Qelizat trupore të njeriut kanë 46 kromozome, të organizuara në 23 çifte. Në disa raste mund të ndodhin ndryshime në këtë numër, siç është rasti te individët me sindroma të ndryshme. Cili nga pohimet më poshtë përshkruan saktësisht ndryshimin e numrit të kromozomeve që ndodh te personat me sindromën Turner?
- (A) Trisomia e kromozomit 18  
 (B) Trisomia e kromozomit 21  
 (C) Trisomia e kromozomeve seksuale  
 (D) Monosomia e kromozomeve seksuale

92. Zana në orën e biologjisë ka prezantuar krahët e fluturës dhe të dallëndyshes që kanë ndërtim të ndryshëm por që kryejnë të njëjtin funksion. Në bazë të këtyre karakteristikave çfarë janë këto organe?


- (A) Divergjente  
 (B) Homologe  
 (C) Mutagjene  
 (D) Analoge



93. Në figurë është paraqitur qeliza trupore në faza të ndryshme të mitozës, të shënuara me numra nga 1 deri në 4. Në fazën **3**, kromozomet janë ndarë dhe lëvizin drejt poleve të kundërta të qelizës.

Si quhet faza e mitozës me numrin 3?


- (A) Profazë
- (B) Anafazë
- (C) Metafazë
- (D) Telofazë



94. Gjatë oogjenezës, qelizat përmes ndarjeve qelizore kalojnë nga qeliza diploide ( $2n$ ) në haploide ( $n$ ). Në cilat qeliza ndodh ndarja e parë meiotike (mejoza I), gjatë së cilës numri i kromozomeve përgjysmohet dhe qeliza bëhet haploide?

- (A) Ootide
- (B) Oogonie
- (C) Oocite primare
- (D) Oocite sekondare

95. Në figurë është paraqitur gastrula që është fazë e zhvillimit embrional gjatë së cilës formohen fletët embrionale (ektoderma, mezoderma dhe endoderma), që janë fillesat e zhvillimit të organeve dhe indeve të trupit.




Cilat organe zhvillohen nga shtresa embrionale e mezodermës?


- (A) Veshkat, testisët, vezoret
- (B) Mushkëritë, pankreasi, mëlçia
- (C) Qimet, puçlat, thonjtë
- (D) Flokët, zorrët, skeleti

96. Andi gjatë lojës së basketbollit rrëzohet dhe lëndohet, ku pas kontrollit mjekësor, mjeku konstatoi se kishte thyerje të këmbës. Si quhet ashti i thyer i Andit i shënuar me numrin 2?

- (A) Femuri
- (B) Patella
- (C) Fibula
- (D) Tibia



97. Lukthi është organ i sistemit të tretjes, muret e brendshme të të cilit janë të mbuluara me një shtresë mukusi, siç tregohet edhe në figurë. Cili është roli kryesor i kësaj shtrese?



- (A) Për të përshpejtuar lëvizjen e ushqimit
- (B) Për të rritur thithjen e lëndëve ushqyese
- (C) Për të prodhuar hormone që tretin ushqimin
- (D) Për të mbrojtur lukthin nga aciditeti dhe veprimi i enzimave

98. Në tabelë janë të shënuara disa gjëndra endokrine, hormonet që i sekretojnë këto gjëndra dhe funksionin e secilit hormon.

|     | Gjëndra             | Hormoni që e sekreton | Funksioni i hormonit                             |
|-----|---------------------|-----------------------|--|
| I   | Hipofiza            | Tiroksinë             | Kontrollon procesin e rritjes                    |
| II  | Tiroidea            | Prolaktinë            | Stimulon prodhimin e qumështit në gjirin e nënës |
| III | Pankreasi           | Insulinë              | E ul nivelin e glukozës në gjak                  |
| IV  | Gjëndra mbiveshkore | Somatotrop            | Rregullon metabolizmin qelizor                   |

Cili rresht në tabelën e dhënë përshkruan saktë gjëndrën, hormonin që e sekreton dhe funksionin e tij?


- (A) I
- (B) II
- (C) III
- (D) IV

99. Gjatë një vizite në pyll, Ana rrëshqiti nga një pjerrësi dhe u ndje në rrezik. Zemra i filloi t'i rrahë shpejt, filloi të marrë frymë thellë dhe shpejt, dhe temperatura e trupit i'u rrit. Cila pjesë e sistemit nervor është përgjegjëse për reagimin e Anës ndaj kësaj situatë?

- (A) Sistemi nervor simpatik
- (B) Sistemi nervor parasimpatik
- (C) Palca e kurrizit
- (D) Truri i mesëm

100. Shqisat në trupin tonë janë përgjegjëse për pranimin e ngacmimeve nga mjedisi i jashtëm. Cili nga funksionet e mëposhtme përshkruan saktë rolin e receptorëve të shikimit në sy?

- (A) Përcaktimi i frekuencës së valëve të zërit
- (B) Rregullimi i lëvizjes së trupit dhe ruajtja e ekuilibrit
- (C) Prodhimi i lëndëve kimike që bartin impulsin nervor nga syri në tru
- (D) Pranimi i energjisë së dritës dhe shndërrimi i saj në sinjale elektrike

76. Komponentët e kompjuterit si procesori, memoria RAM, Hard Disku dhe kartela grafike lidhen mes tyre përmes një pjese kryesore harduerike të quajtur:
- (A) Monitori
  - (B) Tastiera
  - (C) Altoparlantët
  - (D) Pllaka amë (Motherboard)
77. Cili është funksioni kryesor i një kablli SATA në kompjuter?
- (A) Të lidh hard diskun me pllakën amë
  - (B) Të furnizoj me energji monitorin e kompjuterit
  - (C) Të dërgoj të dhënat nga kompjuteri në internet
  - (D) Të lidh tastierën dhe miun me portën USB
- 
78. Ardita punon në një kompani ku çdo ditë hap dhe redakton dokumente, dërgon e-maila dhe menaxhon skedarë në kompjuterin e saj. Programet hapen në dritare të veçanta dhe ajo lëviz ndërmjet tyre me lehtësi. Ky funksion mundësohet nga:
- (A) Kartela grafike
  - (B) Sistemi Operativ
  - (C) Hard Disku
  - (D) Programi antivirus
79. Sistemin operativ Windows, sot mund ta shkarkojmë si version:
- (A) 8 ose 16 bit
  - (B) 16 ose 32 bit
  - (C) 32 ose 64 bit
  - (D) 64 ose 128 bit
80. Në një kabinet të teknologjisë janë të lidhur 10 kompjuterë që ndajnë të njëjtin rrjet lokal dhe mund të komunikojnë ndërmjet tyre. Ky lloj rrjeti quhet:
- (A) USB Network
  - (B) Bluetooth Group
  - (C) Cloud
  - (D) Local Area Network
81. Sulmi i mohimit të shërbimit (Denial of Service – DoS):
- (A) Bënë të paqasshme shërbimin në Internet për shfrytëzues legjitim
  - (B) Bënë të qasshme shërbimin në Internet për shfrytëzues legjitim
  - (C) Bënë të paqasshme shërbimin në Internet për shfrytëzues jo legjitim
  - (D) E ndal krejt qasjen ne Internet
82. Cili nga opsionet e mëposhtme nuk është një funksion i vlefshëm në Excel?
- (A) =IF
  - (B) =SUM
  - (C) =BOLD
  - (D) =AVERAGE

83. Një shitës dëshiron të kopjojë të njëjtën formulë në disa qeliza për rreshta të ndryshëm, por pa ndryshuar referencën e qelizës së TVSH-së që ndodhet në qelizën B1. Referenca në Excel që duhet të përdor ai në mënyrë që adresa B1 të mos ndryshojë gjatë kopjimit të formulës është:

- (A) B1
- (B) \$B1
- (C) B1\$
- (D) \$B\$1

84. Cili është rezultati i qelizës B2, sipas formulës:

- (A) 35
- (B) 15
- (C) 20
- (D) 50

|   | A     | B                  | C |
|---|-------|--------------------|---|
| 1 | Vlera | Rezultati          |   |
| 2 | 35    | =IF(A2>50, A3, A4) |   |
| 3 | 20    |                    |   |
| 4 | 15    |                    |   |

85. Për ta gjetur mesataren e notave nga shkolla e mesme, si në figurë, Joni e përdor funksionin:

- (A) =SUM(B2, C2, D2)
- (B) =SUM(A2, B2, C2, D2)
- (C) =AVERAGE(A2, B2, C2, D2)
- (D) =AVERAGE(B2, C2, D2)

|   | A    | B        | C        | D        | E         |
|---|------|----------|----------|----------|-----------|
| 1 | Emri | Klasa 10 | Klasa 11 | Klasa 12 | Mesatarja |
| 2 | Joni | 4.5      | 4.7      | 4.8      |           |

86. Në Excel, cili është veprimi që do të ndodh nëse zbatohet formula “=MAX(A1:A10)”

- (A) Gjej vlerën më të madhe në rangun e celulave
- (B) Gjej vlerën më të vogël në rangun e celulave
- (C) Numëro vlerat ndërmjet A1 dhe A10
- (D) Gjej mesataren e numrave A1 dhe A10

87. Çfarë rezultati fitohet me ekzekutimin e funksionit =LEFT (A1, 3) në qelizën B1, nëse në qelizën A është shënuar teksti: Universiteti, sikurse në figurën e mëposhtme:

- (A) 333
- (B) LEF
- (C) eti
- (D) Uni

|   | A            | B            | C | D |
|---|--------------|--------------|---|---|
| 1 | Universiteti | =LEFT(A1, 3) |   |   |
| 2 |              |              |   |   |

88. Nëse formula =A\$2 kopjohet në një celulë tjetër, atëherë:

- (A) Pjesa e rreshtit nuk ndryshon
- (B) Pjesa e kolonës nuk ndryshon
- (C) Nuk ndryshon asgjë
- (D) Edhe rreshti edhe kolona ndryshojnë

89. Një fushë (*field*) në një tabelë në Access përfaqëson:

- (A) Një rresht të të dhënave
- (B) Një lidhje ndërmjet dy tabelave
- (C) Një kolonë që përmban të dhëna të një lloji specifik
- (D) Një qelizë

90. Cili objekt në Microsoft Access përdoret për të ruajtur të dhëna?

- (A) Tabela
- (B) Pyetësi
- (C) Raporti
- (D) Formulari

91. Tabelat në bazën e të dhënave në Access ndërlidhen në mes veti, me anë të disa llojeve të relacioneve. Relacioni shumë me shumë ( $\infty - \infty$ ), tek një databazë e lëndëve dhe nxënësve, do të thotë:

- (A) Shumë lëndë mund të shfaqen vetëm tek një nxënës
- (B) Shumë lëndë mund të shfaqen tek shumë nxënës
- (C) Një lëndë mund të shfaqet në shumë nxënës
- (D) Një lëndë mund të shfaqet vetëm tek një nxënës

92. Në një *query* të tabelës “Librat”, në fushën “Titulli” është përdorur kriteri: **LIKE "B\*"**. Rezultati në bazën e të dhënave në Access do të jetë:

- (A) Filtron të gjitha librat që nuk përmbajnë shkronjën B në ndonjë pozitë
- (B) Filtron vetëm librat që nuk kanë në titull një shkronjë B të madhe
- (C) Filtron librat që fillojnë me shkronjën B
- (D) Filtron librat që mbarojnë me shkronjën B

93. Për të detyruar Ilirjanën të fusë në një bazë të të dhënave një numër telefoni sipas modelit të saktë (p.sh. 044/123-456), në Access ajo duhet të përdor vetinë:


- (A) Format → Number
- (B) Input Mask
- (C) Validation Rule
- (D) Caption

94. Cili është elementi kryesor në Power Point ku vendoset përmbajtja e prezentimit, si teksti, imazhet dhe videot?

- (A) Slide
- (B) Chart
- (C) Page
- (D) Sheet

95. Për të filluar prezantimin nga slljadi punues, tek menyuja “*Slide Show*”, sikurse në figurë, klikojmë butonin:

- (A) File
- (B) From Beginning
- (C) From Current Slide
- (D) Record



96. Gjatë përgatitjes së një prezantimi për një projekt shkollor, Dafina dëshiron që çdo sllajd të kalojë me një efekt të veçantë vizual. Për ta realizuar këtë, ajo duhet të përdorë opsionin në PowerPoint:

- (A) Animations
- (B) Design
- (C) Transitions
- (D) Insert

97. Për të shtuar datën aktuale të prezantimit në secilën faqe të prezantimit, veprimet si vijon:

- Ⓐ Nga menyuja “Home”, zgjedhim nën-menynë “Editing”
- Ⓑ Nga menyuja “Insert”, zgjedhim nën-menynë “Header & Footer”
- Ⓒ Nga menyuja “Draw”, zgjedhim nën-menynë “Comment”
- Ⓓ Nga menyuja “Transition”, zgjedhim nën-menynë “Reveal”

98. Çka bënë kodi html:

`<a href="https://rks-gov.net/"> Kjo është ueb faqja e qeverisë</a>`

- Ⓐ Paraqet tekstin: `https://rks-gov.net/`
- Ⓑ Paraqet tekstin: *Kjo është ueb faqja e qeverisë*
- Ⓒ Paraqet tekstin: `https://rks-gov.net/` si link
- Ⓓ Paraqet tekstin: *Kjo është ueb faqja e qeverisë* si link


99. Kur kompjuteri dërgon dhe pranon të dhëna nga interneti, për të komunikuar me serverët përdor një:

- Ⓐ Email adresë
- Ⓑ Kartelë të zërit
- Ⓒ IP adresë
- Ⓓ Fjalëkalim

100. Kombinimi që përmban elemente të ndryshme si tekst, imazhe të lëvizshme dhe zë quhet:

- Ⓐ Përmbajtje multimediale
- Ⓑ Grafikë vektoriale
- Ⓒ Material linear
- Ⓓ Photoshop

76. Në një pjesë të qytetit të Prishtinës po ndërtohet objekti i ri i një fakulteti (FSHMN). Për ta parë në detaje hapësirën përreth, Parsi dhe Parsa blen një hartë në librari.




Hartën që e blen ata të dy shihen detaje të shumta të sipërfaqes së paraqitur, që nënkupton se ata blen një hartë:

- (A) gjeografike
- (B) plan
- (C) topografike
- (D) hidrologjike

77. Buna dhe Drini hartuan një projekt për të prezantuar para klasës. Ata kishin hulumtuar format e relievit të krijuara në natyrë. Në prezantimet e tyre vëreheshin forma sikurse: shtrati i lumit, meandra, luginat e grykat. Nga cila fushë e gjeografisë ishte prezantimi i Bunës dhe Drinit?

- (A) Gjeografia fizike
- (B) Gjeografia shoqërore
- (C) Gjeografia regjionale
- (D) Gjeografia historike

78. Disa maturantë vendosën që të vizitojnë ujëvarat e Mirushës. Autobusi ndaloi në rrugën magjistrale Klinë-Gjakovë, ndërsa nxënësit së bashku me mësimdhënësin duhet të ecin rreth 2.4 km.




Me çfarë distance paraqitet kjo rrugë në hartën me shkallë 1:30000?

- (A) 800 mm
- (B) 8.0 mm
- (C) 8.0 cm
- (D) 80 dm


79. Në hartë e dhënë në shkronjat A,B, C dhe D janë paraqitur zonat e përhapjes së vullkaneve në Europë.

Cila shkronjë në hartën e dhënë paraqet brezin e përhapjes së vullkaneve në Europë.

- (A) A
- (B) B
- (C) C
- (D) D



80. Në figurën e dhënë është paraqitur një profil i tërthortë malet e Zhegocit – Karadak (juglindje e Kosovës).




Çfarë strukture tektonike – relievore paraqet fusha e Anamoravës?

- (A) Graben
- (B) Horst
- (C) Antiklinal
- (D) Sinklinal

81. Në klimadiagramin e dhënë janë paraqitur reshjet mujore dhe temperatura mesatare mujore e ajrit në stacionin e Barcelonës (Spanjë).


**Klimadiagrami i Barcelonës (Spanjë)**



Cila nga pohimet e dhëna është i saktë për veçoritë klimatike të Barcelonës?

- (A) Temperatura e lartë në dimër tregon për klimën kontinentale të qytetit
- (B) Sasia më e vogël e reshjeve gjatë verës tregon për klimën mesdhetare të qytetit
- (C) Amplituda e vogël vjetore e temperaturës tregon për klimën oqeanike
- (D) Diferenca në reshje dhe temperaturë në verë tregon për praninë e lagështisë


82. Në hartën e Kosovës janë paraqitur lumenjtë kryesorë të vendit: ① - Drini i Bardhë, ② - Ibri, ③ - Sitnica, ④ - Lepenci.



Cili nga pohimet e dhëna është i saktë?

- Ⓐ Lumenjtë ②, ③ dhe ④ i takojnë dy sistemeve lumore
- Ⓑ Lumenjtë ①, ② dhe ③ derdhen në të njëjtin det
- Ⓒ Lumenjtë ①, ③ dhe ④ derdhen në të njëjtin lumë
- Ⓓ Lumenjtë ①, ② dhe ④ e kanë burimin nga i njëjti mal

83. Format e relievit në koren e Tokës krijohen nga procese natyrore të ndryshme.



Cili është procesi kryesor i cili ka modeluar relievin në figurën e dhënë duke krijuar format e përshkruara në të?

- Ⓐ Akumulimi i detit
- Ⓑ Rrjedha lumore
- Ⓒ Erozioni akullnajor
- Ⓓ Erozioni karstik

84. Në foto është paraqitur Liqeni i Livadhit në Malet e Sharrit në Kosovë



Cila është origjina e këtij liqeni, bazuar karakteristikat e relievit, formën e luginës si dhe lokacionin e liqenit.

- Ⓐ Akullnajat gjatë pleistocenit kanë modeluar relievin në malet e larta duke krijuar edhe liqene akullnajore
- Ⓑ Lumenjtë në malet e larta erodojnë lugina ku uji është ndaluar duke krijuar liqen lumor
- Ⓒ Meqë Kosova dikur ishte e mbuluar nga deti, atëherë liqeni është mbetje e detit të dikurshëm
- Ⓓ Nga tretja e shkëmbinjve në malet e larta krijohen lugina në të cilën është krijuar liqeni karstik

85. Në Shalën e Bajgorës në lartësi mbidetare rreth 1600 m janë instaluar turbina të erës për prodhimin e energjisë elektrike.




Çfarë rëndësia ka për Kosovën instalimi i kapaciteteve të reja të energjisë së ripërtëritshme?

- Ⓐ Energjia nga era është e shtrenjtë, njësoj edhe prodhimi i lartë i dioksidit të karbonit
- Ⓑ Kosova zvogëlon emetimin e dioksidit të karbonit gjatë prodhimit total të energjisë
- Ⓒ Turbinat e erës ndikojnë në rritjen e emetimit të dioksidit të karbonit
- Ⓓ Emetimi i dioksidit të karbonit nuk ka ndikim në natyrë

86.

**Regjion në botë**


Në hartën e dhënë janë paraqitur disa shtete që njihen si vende të “gjirit”, vendet të Lindjes së Mesme, rezervave të mëdha të naftës, burimi i feve monoteiste etj.



Cili regjion është paraqitur në hartën e dhënë?

- (A) Afrika Veriore
- (B) Evropa Juglindore
- (C) Amerika Jugore
- (D) Azia Jugperëndimore

87. Një grup turistësh ka vendosur që të përshkoj në itinerarin e tyre regjionin perëndimor të Kosovës. Monumentet që do të vizitojnë sipas radhës janë paraqitur me numra në hartë dhe në tabelë.




|           | ①                  | ②                   | ③                   | ④                  |
|-----------|--------------------|---------------------|---------------------|--------------------|
| Rreshti a | Gurra e Radacit    | Ujëvara e Mirushës  | Çarshia e Vjetër    | Kalaja e Prizrenit |
| Rreshti b | Ujëvara e Mirushës | Kalaja e Prizrenit  | Gurra e Radacit     | Çarshia e Vjetër   |
| Rreshti c | Kalaja e Prizrenit | Çarshia e Vjetër    | Ujëvarat e Mirushës | Gurra e Radacit    |
| Rreshti d | Çarshia e Vjetër   | Ujëvarat e Mirushës | Kalaja e Prizrenit  | Gurra e Radacit    |

Cili nga rreshtat në tabelë paraqet saktë pozitën e monumenteve në regjionin perëndimor paraqitur me numrat ①, ②, ③ dhe ④?

- (A) Rreshti a
- (B) Rreshti b
- (C) Rreshti c
- (D) Rreshti d

88. Janë dhënë piramidat e popullsisë së Shqipërisë për vitin 2004 (majtas) dhe 2024 (djathtas).



Cila nga pohimet e dhëna paraqet saktë krahasimin e dy piramidave të popullsisë së Shqipërisë për vitin 2004 dhe 2024.

- (A) Është rritur pjesëmarrja e popullsisë së re në vitin 2024
- (B) Është zvogëluar pjesëmarrja e popullsisë së moshuar
- (C) Popullsia e Shqipërisë është tkurrur në 20 vitet e fundit
- (D) Numri i popullsisë nuk ka pësuar ndryshime

89. Është dhënë teksti për një trevë në Kosovë.

#### Trevë në Kosovë

..... shtrihet në pjesën juglindore të Regjionit Lindor të Kosovës. Në veri kufizohet me Gollakun, në jug me Karadakun, kurse në perëndim kurrizi i ulët me fushën e Kosovës. Pjesët fushore ndodhen në 500 m lartësi mbidetare, kurse në ato periferike-malore lartësia arrin deri në 1,000 m. Nëpër të rrjedh lumi Morava e Binçës, të cilit në skajin lindor i bashkohet Lumi i Shtrembër (Krivareka), e që përmes grykës së Konçulit derdhen ujërat në Moravën Jugore. Përbëhet nga shkëmbinjtë e vjetër mbi të cilët janë vendosur shtresa të reja me prejardhje lumore. Klima është kontinentale, ndërkaq tokat me plleshmëri të lartë kanë mundësuar zhvillimin e bujqësisë. Kultivohen drithërat dhe perimet, ndërsa në të kaluarën edhe kulturat industriale, sidomos ajo e duhanit. Qendra më e madhe e Anamoravës është Gjilani (70,000 b.).


Për cilën trevë në Kosovë bëhet fjalë në tekstin e dhënë?

- (A) Anamoravën
- (B) Llapushën
- (C) Llapin
- (D) Drenicën


90. Në hartën e dhënë janë paraqitur pesë lokacione të ndryshme të botës të emërtuara me shkronjat A, B, C, D dhe X. Mesdita (ora 12:00) është në lokacionin X.

Në cilin lokacion është ora 14:00?

- (A) Lokacioni A
- (B) Lokacioni B
- (C) Lokacioni C
- (D) Lokacioni D



91. Popullsia në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka një shpërndarje të pabarabartë. Në hartën 1 është paraqitur dendësia e popullsisë ndërsa në hartën 2 janë dhënë dy hapësira me dendësi të ndryshme të popullsisë.




Cila nga alternativat e dhëna tregon saktë dendësinë e popullsisë në hapësirat e dhëna në hartë?

- (A) Hapësira 1 – dendësi më e madhe meqë dominon relievi i lartë dhe klimë të thatë
- (B) Hapësira 2 – dendësi më e vogël për shkak të maleve Kordilere dhe akullnajave
- (C) Hapësira 2 – dendësi më e madhe për shkak të relievit fushor dhe klimës së butë
- (D) Hapësira 1- dendësi mesatare rreth ultësirës së lumit Misisipi dhe pyjeve tropikale

92.


Maturantët e një shkolle nga kryeqyteti kanë vendosur të vizitojnë Selanikun. Para se të arrijnë në kufirin me Maqedoninë e Veriut ata hasin në një grykë që është paraqitur në foto.



Në cilën grykë duhet të kalojnë maturantët për të arritur në kufirin me Maqedoninë e Veriut?

- (A) Grykën e Konqulit
- (B) Grykën e Carralevës
- (C) Grykën e Llapushnikut
- (D) Grykën e Kaçanikut

93. Në figurë janë paraqitur diellosja dhe vranësirat për qytetin e Prishtinës.



Cili nga pohimet e mëposhtme është i saktë?


- (A) Të gjithë muajt e vitit kanë diellosje të njëjta, ndërsa vranësirat kanë ndryshime mujore
- (B) Diellosja më e madhe në muajt korrik dhe gusht e në grafik paraqitet me numër 2
- (C) Më shumë vranësira në muajt korrik dhe gusht e në grafik paraqitet me numër 2
- (D) Korriku dhe gushti janë dy muajt me më së paku diellosje e më së shumti vranësira

94.

Një grup maturantësh nga shkolla "Pavarësia" vendosën që pushimet verore t'i kalojnë së bashku duke vizituar disa qytete bregdetare, dhe duke udhëtuar me anije. Ata u nisën nga porti i Shëngjinit, pastaj vazhduan itinerarin në Sarandë, në Kretë (Heraklion) dhe pas disa ditësh arritën në Selanik.

Janë dhënë detet:

1. Deti Adriatik
2. Deti Egje
3. Deti i Kretës
4. Deti Jon
5. Deti Mesdhe



Cila është renditja e saktë e deteve që maturantët nga shkolla Pavarësia kaluan nga Shëngjini deri në Selanik?

- (A) 1 - 2 - 5 - 4 - 3
- (B) 1 - 3 - 4 - 2 - 5
- (C) 1 - 4 - 5 - 3 - 2
- (D) 1 - 4 - 2 - 5 - 3


95. Në hartën e dhënë me ngjyrë të mbyllët është paraqitur njëra nga zonat bimore që shtrihet në disa kontinente.



Cila zonë bimore është paraqitur me ngjyrë të errët në hartë?

- (A) Tundrat që karakterizohen me bimësi të ulët e të pakët, myshqe, likene dhe shkurre të vogla
- (B) Tajgat që përbëhen kryesisht nga pyjet halore me pisha e bredh, me gjelbrim të përherëshëm
- (C) Savanat që karakterizohen me barëra të larta dhe disa pemë të shpërndara
- (D) Xhunglat që përbëhen nga bimësi e dendur me pemë të lart që rriten në lagështi të madhe

96. Në figurë e dhënë është paraqitur rrjedha e një lumi.



Bazuar në formën e shtratit të lumit në figurë, cili nga profilet tërthorë 1, 2, 3 dhe 4 përfaqëson seksionin A–A' në hartën e lumit?

- (A) Profili 1
- (B) Profili 2
- (C) Profili 3
- (D) Profili 4

97.

*Liçeni i Ujmanit*

Cila nga pohimet e dhëna është e saktë për liçenin e Ujmanit?

- Ⓐ Liçeni i Ujmanit shërben vetëm për peshkim dhe turizëm, pa ndonjë funksion tjetër ekonomik apo Teknik
- Ⓑ Liçeni i Ujmanit është një liçen natyror pa ndonjë ndikim të madh në jetën e përditshme të qytetarëve
- Ⓒ Liçeni i Ujmanit është një rezervuar artificial që furnizon me ujë rajonin e Kosovës, ndihmon bujqësinë dhe prodhon energji përmes hidrocentralit në Ujman
- Ⓓ Liçeni i Ujmanit përdoret vetëm për sporte ujore dhe aktivitete rekreative në stinën e verës

98.



Cila është rëndësia e Trepçës për Kosovën?

- Ⓐ Trepça është vetëm një atraksion turistik dhe shërben kryesisht për të tërhequr vizitorë në Mitrovicë. Ajo nuk ka më rol aktiv ekonomik, por ruhet për vlerat historike.
- Ⓑ Trepça përfaqëson një pasuri të madhe natyrore me ndikim në punësim, industri dhe eksport, që nëse menaxhohet mirë, mund të ndihmojë në zhvillimin ekonomik të Kosovës
- Ⓒ Trepça është një minierë pa aktivitet real, që ndihmon vetëm zonat rurale përreth me pak vende pune sezonale, por nuk ka ndikim më të gjerë në zhvillimin ekonomik të Kosovës
- Ⓓ Roli i Trepçës është vetëm arsimor – përdoret për trajnimin e nxënësve të shkollave profesionale, por nuk përfshihet në ekonominë tregtare të Kosovës

99.

***Drini i Bardhë***

*Në lumin Drini i Bardhë, banorët e fshatit Gexhë kanë vënë re thellimin e shtratit të lumit dhe dëmtimin e tokave përreth pas nxjerrjes së rërës dhe zhavorrit për ndërtim.*



Cila nga pasojat më poshtë është më e mundshme në këtë rast?

- (A) Zhvillimi i turizmit ekologjik
- (B) Rritja e prodhimit bujqësor në zonë
- (C) Erozioni i vazhdueshëm i tokës bujqësore
- (D) Shfrytëzim më i mirë i energjisë diellore

100.

***Rahoveci***

*Regjioni i Rahovecit është i njohur për zhvillimin e bujqësisë, sidomos kultivimin e rrushit dhe prodhimin e verës. Në vitet e fundit, janë zhvilluar edhe aktivitete turistike si shëtitjet nëpër kantina dhe degustimi i verës.*



Si ndikon zhvillimi i bujqësisë dhe turizmit në regjionin e Rahovecit në ekonominë lokale?

- (A) Zhvillimi i turizmit ka përmirësuar infrastrukturën dhe ka rritur të ardhurat nga sektori i blegtorisë
- (B) Aktivitetet bujqësore janë të pamjaftueshme dhe nuk kontribuojnë ndjeshëm në zhvillimin ekonomik
- (C) Zhvillimi i turizmit dhe bujqësisë ka ndikuar në rritjen e papunësisë për shkak të mungesës së trajnimit dhe burimeve financiare
- (D) Aktivitetet bujqësore, veçanërisht prodhimi i verës dhe turizmi, po kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe krijimin e mundësive për punësim të qëndrueshëm

76. Antagonizmi klasor në periudhen historike të kohës së vjetër shprehet përmes:

- (A) punëtorëve dhe kapitalistëve
- (B) feudalëve dhe fshatarëve
- (C) kapitalistëve dhe bujkërobërve
- (D) skllavopronarëve dhe sklleverve

77. Territori i Kosovës është i pasur me vendbanime të periudhës së neolitit dhe antike.

Figurat e paraqitura shprehin nivelin kulturor që tregojnë:




Figura 1 - Dea Dardane

Figura 2 – Hynjësja në fron

Figura 3 - Okarina

Figura 4 - Vrapuesia e Prizrenit

- (A) zhvillimin dhe avancimin civilizues të popullatës
- (B) prapambeturin kulturore dhe ekonomike të popullatës
- (C) mungesën e shijes artistike të krijuesve
- (D) vlerat e ulëta dhe paraqitjen jo adekuate të objekteve

78. Në fillim të vitit 1460, Skënderbeu hyri në një fazë të re të aktivitetit diplomatik e ushtarak. Sukseset që kishte arritur në luftë kundër osmanëve ndikuan të gjithë mbretërit e Evropës t'i kthenin sytë drejt tij, ku bashkëpunimi me mbretërinë e Napolit flet për:

- (A) rolin vendimtar të Mbretërisë së Napolit në luftën kundër osmanëve
- (B) rendësin ndërkombëtare që kishte fituar lufta e shqiptarëve nën udhëheqjen e Skënderbeut
- (C) karakterin lokal të luftës së Gjergj Kastriotit Skënderbeut
- (D) qëndrimin neutral të Evropës ndaj fitoreve të Gjergj Kastriotit Skënderbeut

79. Që nga viti 1991 fillon krijimi i grupeve të armatosura në territorin e Kosovës. Në mesin e grupeve ishin grupi Drenicës me në krye Adem Jasharin, grupi i Llapit me Zahir Pajazitin, i Rrafshit të Dukagjinit me Luan Haradinaj, Ardian Krasniqin, Sali Çekaj etj

Paraqitja publike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ndikojnë në:

- (A) angazhimin e forcave të NATO-së që të bombardojnë caqet serbe
- (B) mbajtjen e Konferencës së Rambujesë
- (C) forcimin e moralit dhe rritjen e rezistencës tek popullata shqiptare
- (D) lidhjen e Marrëveshjes së Kumanovës dhe largimin e forcave serbe nga Kosova

80.

**Hyjesha Dardane**

Në fotografinë e dhënë është paraqitur Hyjesha Dardane. Ky bust i takon periudhës së shekujve II-III. Në këtë bust gruaje shohim gruan ilire me një shami zbukuruese që i varet deri në supe, vathët e mëdhenj dhe qaforja zbukuruese mjaft e dukshme.



Këto elemente të bustit shprehin:

- (A) nivelin e lartë të kulturës ilire dhe respektin ndaj figurës së gruas
- (B) ndikimin e lartë të kulturës greke në kulturën ilire
- (C) gërshetimin kulturor në mes lindjes së largët me popullatën ilire
- (D) adhurimin e idhujve në formën e figurës së gruas tek iliret

81. Burimet historike të shkruara në letër tregojnë se ato janë:

- (A) Njësoj të vjetra si të gjitha burimet tjera
- (B) Me të vjetra në krahasim me burime të shkruara në papirus
- (C) Me të vjetra në krahasim me burime të shkruara në pllaka të argjilës
- (D) Më të reja në krahasim me burime të shkruara në pergamen

82. Në fotografitë e dhëna janë paraqitur mbretër ilir që kanë qeverisur shtetin e tyre.

Veshjet e mbretërve ilir të paraqitur në foto tregojnë për:

- (A) përfitimet e mëdha që ata kishin nga luftërat pushtuese
- (B) ndikimin e kulturës romake të veshjeve
- (C) nivelin e zhvilluar të aristokracisë ushtarake ilire
- (D) mënyrën se si mbretërit ilir paraqiteshin para ekspeditave luftarake



Foto 1. Kliti



Foto 2. Bardhyli



Foto 3. Glauku


83. Në fotografinë e dhënë është paraqitur Kuvendi i Lidhjes së Lezhës më 2 mars 1444.



Duke analizuar qëndrimin e figurës së Skënderbeut në foto kuptojmë:

- (A) rolin udhëheqës të Skënderbeut në Kuvendin e Lezhës
- (B) dyshimin e princërve arbëror në rolin udhëheqës të Skënderbeut
- (C) mungesën e unitetit politik të arbërore kundër Perandorisë Osmane
- (D) rolin komandues të Skënderbeut kundër Perandorisë Osmane

84. Në fotografinë e dhënë është paraqitur abetarja e parë shqipe e botuar në vitin 1844.



Në bazë të analizës së fotografisë tregoni se me cilin alfabet Naum Veqilharxhi e hartoi abetaren ?

- (A) Alfabeti të mbështetur nga shkronjat greke
- (B) Alfabeti origjinal krijuar nga vetë autori
- (C) Alfabeti të mbështetur nga shkronjat romake
- (D) Alfabeti të kopjuar nga shkronjat mesjetë

85. Në fotografinë e dhënë është paraqitur mënyra e punimit të tokës në një periudhë të caktuar historike.

Në bazë të mjeteve të përdorura, veshjeve dhe armatimit, për cilën periudhë historike bëhet fjalë?



- (A) Periudhën mesjetare
- (B) Periudhën antike
- (C) Periudhën moderne
- (D) Periudhën klasike

86. Për cilat arsye Rusia dhe Serbia ishin kundër reformimit të Perandorisë Osmane përmes Reformave të Tanzimatit të vitit 1839.

- (A) Për arsye të ruajtjes së raporteve të mira diplomatike që kishin me Francën dhe Italinë
- (B) Për forcimin e balansit në mes Shqipërisë dhe Italisë dhe ndaljen e ekspansionit Austro-Hungarez në Ballkan
- (C) Për ta mundur Malin e Zi që ti pushtonte territoret shqiptare
- (D) Për ta dobësuar dhe për të zotëruar territoret e saja në Detin e Zi dhe në Ballkan

87. Në tabelën e dhënë janë paraqitur ngjarjet dhe periudhat historike.

|           | Ngjarjet                                | Periudha historike |
|-----------|---|--------------------|
| Rreshti 1 | Themelimi i qytetërimit të Mesopotamisë | Koha antike        |
| Rreshti 2 | Zbulimet e mëdha gjeografike            | Koha e mesjetës    |
| Rreshti 3 | Themelimi i qytetërimit romak           | Koha moderne       |
| Rreshti 4 | Zbulimi i shtypshkronjës                | Koha e metaleve    |

Cili nga rreshtat e dhënë paraqet saktë ngjarjen që i takon periudhës historike?

- (A) Rreshti 1
- (B) Rreshti 2
- (C) Rreshti 3
- (D) Rreshti 3

88. Në fotot e dhëna janë paraqitur rrënojat e mbetura nga teatri antik i Butrintit dhe parku arkeologjik i Apolonisë.



Çfarë dëshmojnë fotot e dhëna?

- (A) Mos kujdesin ndaj objekteve të trashëgimisë kulturore antike
- (B) Prapambeturin kulturore të Ilirisë në raport me vendet tjera mesdhetare
- (C) Zhvillimin e lartë kulturor të Ilirisë në kohën antike
- (D) Pjesëmarrjen e fiseve germanike në ndërtimin e tyre

89. Është dhënë teksti:

*”Kryengritja e masave popullore të revoltuara shpërtheu, më 12 korrik 1789 .Pas dy ditësh në kryengritje më 14 korrik populli zotëroi fortesën e Bastiljes një burg i konsideruar si simbol i tiranisë feudale dhe i absolutizmit mbretëror. Në qytet pushtetin e mori borgjezia e pasur dhe organizoj forcat e veta të armatosura që u quajt garda kombëtare.”*

Për cilën ngjarje historike bëhet fjalë në tekstin e dhënë :

- (A) Organizimin e Komunës së Parisit
- (B) Revolucionin borgjez në Francë
- (C) Kongresin e Versajit në Paris
- (D) Kongresin e Parisit në Francë

90.

*Kapitulli i një libri të Historisë*

*Kapitulli 1*

*1.1 Veprimtaria patriotike e Arbëresheve të Italisë*

*1.2 Hartimi i Evetarit për mësimin e gjuhës shqipe*

*1.3 Lufta për emancipimin kulturor shqiptar në shek.XIX*

*14. Naum Veqilharxhi, Jeronim de Rada, Kostandin Kristoforidhi*

Cili do të ishte titulli në kapitullin 1, bazuar në përmbajtjen e dhënë?

- (A) Formimi i pashallëqeve shqiptare
- (B) Fillimi i Luftës së Parë Ballkanike
- (C) Lidhja shqiptare e Prizrenit
- (D) Rilindja kombëtare shqiptare

91.

Në tabelën e dhënë janë paraqitur repartet ushtarake, religjioni dhe sistemi pronësor në Perandorinë Osmane.

|           | Repartet ushtarake | Religjioni | Sistemi pronësor |
|-----------|--------------------|------------|------------------|
| Rreshti 1 | Jeniqerë           | islam      | timar            |
| Rreshti 2 | Mercenar           | krishterë  | feudal           |
| Rreshti 3 | Spahinjë           | ateist     | kapitalist       |
| Rreshti 4 | Stratitot          | politeist  | komunist         |

Cili nga rreshtat e dhënë paraqet saktë konceptet që lidhen me Perandorin Osmane?

- (A) Rreshti 1
- (B) Rreshti 2
- (C) Rreshti 3
- (D) Rreshti 4

92. Cilat ishin disa nga arsyet që Prizreni u zgjodh qytet më i përshtatshëm për mbajtjen e Kuvendit shqiptar me 1878?

- (A) Prizreni ishte ndër qytetet më të vogla të Shqipërisë dhe gjeografikisht shtrihej në lindje të territoreve osmane
- (B) Prizreni ishte ndër qytetet më të mëdha të Shqipërisë dhe gjeografikisht shtrihej në qendër të territoreve etnike shqiptare
- (C) Prizreni ishte ndër qytetet më të bukura të Shqipërisë dhe gjeografikisht shtrihej me afër shteteve evropiane
- (D) Prizreni ishte ndër qytetet me pasuri më të shumta në Shqipëri dhe gjeografikisht shtrihej në qendër të territoreve osmane

93. Cila nga pohimet e dhëna për Ilirët është e saktë?

- (A) Ilirët ishin popullatë e vjetër që në kohën antike banonin në pjesën lindore të Ballkanit të sotëm
- (B) Ilirët ishin popullatë e vjetër që në kohën mesjetare banonin në pjesën lindore të Ballkanit të sotëm
- (C) Ilirët ishin popullatë autoktone që në kohën antike banonin në pjesën perëndimore të Ballkanit të sotëm
- (D) Ilirët ishin popullatë antike që në kohën e re banonin në pjesën jugore të Ballkanit të sotëm

94.

*”Në mbledhjen e 19 qershorit të vitit 1924 qeveria e përkohshme në Tiranë shpalli një program të përberë nga 20 pika që parashikonin reforma administrative, përmirësimin e gjendjes së popullit, arsimit dhe shëndetësisë. Mirëpo shumë nga këto premtime nuk u realizuan. Mungesa e njohjeve nga shtetet e huaj si dhe veprimi nga jashtë beri që kjo qeveri të bie me 24 dhjetor të vitit 1924”*

Bazuar në tekstin e dhënë, për qeverinë e cilit politikan shqiptarë bëhet fjalë?

- (A) Rexhep Mitrovicës
- (B) Fan Nolit
- (C) Ernest Koliqit
- (D) Mustafa Krujës

95.

Pas pushtimit osman të Arbërisë veriore dhe shtypjes së rezistencës, grupe të popullatës u zhvendosen në zona malore dhe atje aplikuan të drejtën zakonore sipas Kanunit të Lek Dukagjinit. Rregullat e kanunit ishin të rrepta dhe atyre duhej përmbajtur secili banor në mënyrë që të ruhej rendi dhe qetësia në ato vende.

Perse u aplikua Kanuni në mesin e shqiptarëve gjatë Pushtimit osman?

- (A) Për të krijuar një sistem paralel të drejtësisë dhe për të mbajtur sa më gjatë pushtetin në duar të malësorëve
- (B) Sepse shqiptaret nuk e pëlqenin sistemin osman juridik që lejonte martesat në mes fiseve dhe nxiste hakmarrjen
- (C) Për të ikur sistemit juridik osman që ishte në kundërshtim me traditën shqiptare dhe bazohej në ligje islame
- (D) Sepse banorët e qyteteve kishin migruar në Itali dhe malësoret duhej të vetmuar të luftonin kundër osmanëve

96.

**Prishtina 1913**

Në foton e dhëna është paraqitur një pamje e qytetit të Prishtinës në vitin 1913 ku vërehen ndërtesa të ulëta dhe rrugë te pa rregulluara, mungese e komunikacionit dhe mungesë zhvillimi të përgjithshëm



FB024; Street in Prishtina, Kosovo (Photo: Fred Boissonnas, 1913).

Çfarë tregon fotografia e dhënë?

- (A) Se shqiptarët nuk u penguan për ta zhvilluar vendin e tyre por vullnetarisht migruan në vise të ndryshme të Evropës për një jetë më të mirë
- (B) Se trevat shqiptare nuk ishin zhvilluar për shkak të pushtimit të gjatë dhe prapambetjes së Perandorisë Osmane si dhe shkatërrimit që i bënte serbet gjatë Luftërave ballkanike
- (C) Se Perandoria Osmane bënte dallime në mes të qytetarëve dhe fshatareve duke e ndihmuar fshatin dhe mos zhvilluar qytetin .
- (D) Se Perandoria Osmane i kishte privilegjuar vetëm një pjesë të shtetit shqiptar e pjesën tjetër e kishte lenë pa zhvilluar

97. Çka solli Plani “Marshall” që SHBA-të e aplikuan në Evropës Perëndimore pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

- (A) Ndihma në planin ushtarak dhe kulturor
- (B) Ndihma në forcimin e demokracisë dhe militantizmit
- (C) Ndihma në mbrojtjen nga shtetet socialiste dhe diktatoriale
- (D) Ndihma dhe rimëkëmbjen ekonomike

98. Cili personalitet shqiptar u cilësua nga Vatikani si “Mbrojtës i Krishterimit “ dhe “Kapiten i Përgjithshëm i Selisë së Shenjtë” ?

- (A) Gjergj Kastrioti Skënderbeu i Krujës
- (B) Karl Topia i Durrësit
- (C) Moisi Golemi i Dibrës
- (D) Pjeter Bogdani ipeshkvi i Kosovës

99. Lufta e popullit turk nën udhëheqjen e Kemal Pashë Atatürkut e viteve 1919-1923 nga historianet modern u karakterizua si luftë :

- (A) pushtuese sepse synonte vendosjen e serishme të sistemit timar në Ballkan
- (B) pushtuese sepse synonte nënshkrimin e serishëm të vendeve ballkanike
- (C) çlirimtare për tu liruar nga sundimi bizantin dhe për të sjellë në pushtet sulltanin
- (D) çlirimtare dhe demokratike për ta ndryshuar sistemin e vjetër osman

100. Kampet e përqendrimit të themeluara nga regjimi i Hitlerit gjatë Luftës së Dytë Botërore shërbyen për:

- (A) Strehimin dhe përkujdesjen e popullatës së ikur nga shtetet e bllokut socialist
- (B) Strehimin e të plagosurve dhe të sëmurëve si pasojë e bombardimeve nga aleatet
- (C) Realizimin e shfarosjes së hebrenjve dhe eliminimin e popullatave të pa dëshiruara
- (D) Realizimin e stërvitjeve ushtarake dhe likuidimin e kundërshtarëve politik

76. Tërësia e individëve e cila karakterizohet nga ndërveprimi për të arritur një qëllim të caktuar dhe ndajnë një identitet të përbashkët, paraqet:

- (A) organizatën qeveritare
- (B) grupet shoqërore
- (C) institucionet shoqërore
- (D) rrjetet shoqërore

77.

*Janë dhënë elementet:*

- *Gjuha e standardizuar dhe kultura e dallueshme*
- *Kujtesa e përbashkët dhe ndjenja e solidaritetit*
- *Besimi në prejardhjen e përbashkët dhe vetëdija e përkatësisë*
- *Territori dhe organizimi politiko-juridik*

Elementet e dhëna janë pjesë e patjetërsueshme e:

- (A) fisit
- (B) klanit
- (C) popullit
- (D) kombit

78. Lëvizjet shoqërore brenda feve të cilat konsiderohen antimoderniste, antisekulare dhe të cilat kërkojnë kthimin në një traditë zanafillore, paraqet lëvizjet:

- (A) tradicionaliste
- (B) fundamentaliste
- (C) sekulariste
- (D) radikaliste

79. Dy institucionet kryesore ndërkombëtare që funksionojnë në aspektin e nxitjes së rritjes ekonomike të vendeve në zhvillim përmes kredive zhvillimore dhe sigurimin e stabilitetit financiar dhe monetar janë:

- (A) Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar
- (B) Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe Organizata Botërore e Tregtisë
- (C) Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar
- (D) Banka Botërore dhe Organizata Botërore e Tregtisë

80.


*Janë dhënë karakteristikat:*

- *Organizata e Kombeve të Bashkuara*
- *Integrimi në organizata ndërkombëtare*
- *Dobësimi i sovranitetit të shtetit*
- *Institucione mbikombëtare*

Bazuar në karakteristikat e dhëna, cili dimension i globalizimit është paraqitur?

- (A) Dimensioi Politik
- (B) Dimensioi Ekonomik
- (C) Dimensioi Teknologjik
- (D) Dimensioi Kulturor

81. Grafiku i dhënë paraqet prirjen e përgjithshme që raportohet në mënyrë të përsëritur nga OECD në testimet PISA.



Cila nga pohimet e dhëna është e saktë bazuar në grafikun e dhënë?

- (A) Nxënësit nga familjet me status socio-ekonomik më të ult kanë rezultate më të larta
- (B) Nxënësit nga familjet me status socio-ekonomik më të lartë kanë rezultate më të ulëta
- (C) Nxënësit nga familjet me status socio-ekonomik më të lartë kanë rezultate më të larta
- (D) Nuk ka fare ndërlidhje mes statusit socio-ekonomik dhe rezultateve të të nxënësve

82.

### Norvegjia

Disa nga karakteristikat kryesore të Norvegjisë:

- Zgjedhjet e lira dhe të ndershme
- Sundim i ligjit njësoj për të gjithë
- Liri qytetare dhe të drejtat e Njeriut
- Pjesëmarrje qytetare në çështjet e qeverisjes



Bazuar në burimin e dhënë themi se Norvegjia konsiderohet:

- (A) Shtet në tranzicion
- (B) Shtet demokratik
- (C) Shtet autoritar
- (D) Shtet diktatorial

83. Në cilin sistem ekonomik ndodh ndarja e punës më e specializuar?

- (A) Shoqëri industriale
- (B) Shoqëri feudale
- (C) Shoqëri pastorale
- (D) Shoqëri nomade

84. Në disa shkolla është organizuar “Java e sportit” duke organizuar turne në sporte të ndryshme si futboll, basketboll etj. Secili turne ka pasur numër të caktuar të ekipeve, numër të caktuar të lojtarëve për ekipe si dhe minutazh të limituar për lojën.

Cili lloj i ndërveprimit është paraqitur në këtë rast?

- (A) Bashkëpunimi
- (B) Vullnetarizmi
- (C) Koordinimi
- (D) Gara

85. Karakteristikë e kujt është sistemi i shtresëzimit shoqëror, i cili është ndërtuar mbi idenë e prejardhjes së pastër, sipas besimit hindu, dhe i cili është i mbyllur dhe i pandryshueshëm?

- (A) Skllavërisë
- (B) Klasave
- (C) Kastave
- (D) Shtresave feudale

86. Cilat nga këto rrethana shoqërore ndikuan në lindjen e sociologjisë si shkencë në shekullin XIX?

- (A) Revolucioni Industrial dhe Revolucioni Francez
- (B) Luftërat botërore dhe zhvillimi i teknologjisë moderne
- (C) Zbulimet gjeografike dhe kolonializmi mesjetar
- (D) Periudha e rilindjes dhe përhapja e fesë

87. Është dhënë teksti

*Në një fshat të vogël në veri të Kosovës, komuna po planifikon të hap një çerdhe të re. Për ta bërë këtë, ata filluan të mbledhin të dhëna për banorët. Sipas rezultateve, në këtë fshat jetojnë rreth 2,500 banorë, shumica janë të rinj nën moshën 30 vjeçare dhe ka një numër të madh familjesh me nga 3 deri në 5 fëmijë. Gjithashtu, është vërejtur se shumica e prindërve janë të punësuar dhe kanë nivel të mesëm arsimimi. Komuna beson se hapja e një çerdheje do të ndihmonte shumë familjet e reja që kanë nevojë për kujdes për fëmijët e vegjël gjatë kohës së punës.*

Cilët faktorë u përmendën në tekstin e dhënë?

- (A) Politik
- (B) Demografik
- (C) Teknologjik
- (D) Progresiv

88. Është dhënë teksti

*Në fillim të viteve 1990, shqiptarëve në Kosovë iu ndalua pjesëmarrja në jetën publike. Ata u detyruan të largohen nga puna dhe institucionet shtetërore, dhe shkollat u ndanë sipas grupeve etnike. Shqiptarët u detyruan të shkonin në shkolla të ndara nga serbët, duke u përjashtuar kështu nga jeta publike dhe institucionet arsimore. Ky proces izolues çoi në një ndarje të thellë të shoqërisë, ku shqiptarët dhe serbët jetonin në kushte të ndryshme.*

Çfarë paraqet gjendja e përshkruar në tekstin e dhënë?

- (A) Asimilimi
- (B) Pluralizëm kulturor
- (C) Gjenocid
- (D) Segregacion

89. Cili term përshkruan një grup brenda një kulture më të gjerë që ka norma, vlera dhe stile të veçanta që e dallojnë nga të tjerët, por nuk janë në kundërshtim me kulturën mbizotëruese?

- (A) Nënkulturë
- (B) Kundërkulturë
- (C) Kulturë transnacionale
- (D) Kulturë komercialiste

90. Cila nga pohimet e dhëna përshkruan rolin e korporatave transnacionale në procesin e globalizimit?

- (A) Izolimi i tregjeve kombëtare
- (B) Zhvillimi i ekonomive lokale të vogla
- (C) Rritja e punës bujqësore tradicionale dhe prodhimi i barabrtë global
- (D) Ndërlidhja e tregjeve globale përmes prodhimit dhe konsumit

91. Është dhënë teksti:

*Në botën moderne ka aq shumë informacion, saqë ne nuk mund ta përvetësojmë dot të tërin për të kuptuar se çfarë po ndodh vërtet. Mediat i thjeshtojnë gjërat për ne dhe vendosin se çfarë të "bëjnë të vërtetë"; përsëritja e figurave dhe historive të caktuara na bën të besojmë ato si "realitet". Si pasojë, gjërat dhe ngjarjet e botës fizike – në formën e tyre të papërpunuar, të pashpjeguar dhe të paambulazhuar – nuk janë më të arritshme për ne. Kjo çon në një humbje të shuman-shmërisë sonë. Si përfundim, ne jetojmë në një botë që ka përherë e më shumë informacion dhe përherë e më pak kuptim.*

Bazuar në tekstin e dhënë, cili nga autorët e mëposhtëm dhe cila perspektivë teorike përfaqësohen në këtë përshkrim?

- (A) Karl Marx – Perspektiva materialiste mbi strukturat ekonomike dhe alienimin
- (B) Jean Baudrillard – Perspektiva postmoderne mbi simulimin dhe hiper-realitetin
- (C) Bell hooks – Perspektiva feministe mbi përfaqësimin gjinor në media
- (D) Anthony Giddens – Perspektiva e strukturimit dhe ndikimi i modernitetit në punë

92. Është dhënë teksti

*Në një zonë industriale afër një qyteti të madh në Kosovë, punëtorët e një kompanie veshjesh që prodhon për tregun evropian punojnë nga 12 orë në ditë me një pagë minimale prej 350 eurosh në muaj. Ndërkohë, pronari i fabrikës udhëton shumë shpesh jashtë vendit për pushime, ka stil luksoz jetese, dhe përfiton të ardhura të kënaqshme mujore nga puna e punëtorëve. Punëtorët ndihen të shfrytëzuar dhe kohët e fundit kanë filluar të bashkohen për të kërkuar kontrata të rregullta pune, paga më të larta dhe kushte më të mira. Kjo ka shkaktuar përplasje me menaxhmentin e kompanisë.*

Cila teori sociologjike është përshkruar në tekstin e dhënë?

- (A) Teoria e superioritetit
- (B) Teoria e evolucionit
- (C) Teoria e konfliktit
- (D) Teoria e Jurgen Habermas

93. Cilat elemente pasqyrojnë identitetin kulturor?

- (A) Gjuha, zakonet, përkatësia etnike
- (B) Shtetësia, dokumentet personale, pasuria
- (C) Gjatësia trupore dhe karakteristikat fizike
- (D) Tiparet psikologjike të trashëguara

94. Është dhënë teksti:

*Agjencia e Statistikave të Kosovës ka publikuar të dhënat për numrin e përgjithshëm të banorëve rezident në Kosovë që rezulton të jetë 1,602,515. Popullsia e Kosovës është përqendruar më shumë në zonat urbane theksohet në raportin e ASK-së. 795,627 banorë jetojnë në këto zona apo 50.18% e popullsisë. Ndërkohë që në zonat rurale jetojnë 789,939 banorë apo 49,82% e popullsisë.*

Cilat procese sociologjike paraqiten përmes këtyre të dhënave të ASK-së që tregojnë përqendrimin e popullsisë në Kosovë?

- (A) Rritja e ndërgjegjësimit mbi ndryshimet klimatike në zonat rurale
- (B) Etnocentrizmi dhe homogjeniteti kulturor
- (C) Urbanizimi dhe ndryshimet në strukturën demografike
- (D) Segregimi racial urban dhe asimilimi kulturor

## 95. Është dhënë teksti

*Drini dhe Buna janë vëlla e motër. Ata jetojnë me prindërit dhe gjyshen e tyre në një shtëpi. Ata janë ende të moshës së re dhe ende nuk shkojnë në shkollë. Ditët i kalojnë në shtëpi, me prindërit dhe me gjyshen e tyre. Pothuajse çdo ditë, gjyshja u tregon përralla të moçme, ndërsa nëna e babai flasin me ta për si e kanë kaluar ditën, çfarë ka ndodhur, shohin emisione për fëmijë bashkë dhe para gjumit u lexojnë tregime të shkurtra. Kështu, Drini dhe Buna kanë mësuar si të sillen me njëri-tjetrin, me anëtarët e familjes dhe me të tjerët, këta duan e këjo, kujt t'i besojnë e kujt jo, kujt t'i frikësohen e kujt jo, si të vishen e si jo, çfarë të hanë e çfarë jo, si të hanë e si të mos hanë, çfarë shprehjesh të përdorin në shtëpi e në lagje e çfarë jo, e shumë e shumë të tjera, që u ka ndihmuar atyre të bëhen pjesëtarë të pranuar të bashkëmoshatarëve të tyre në lagje, të komunitetit në shkollë, më vonë në punë, etj.*

Çka paraqet dukuria e përshkruar në tekst dhe efekti i saj tek Drini dhe Buna?

- (A) Edukim formal
- (B) Familje e bërthamë
- (C) Familje patriarkale
- (D) Shoqërim primar

## 96. Është dhënë teksti

*Sipas një skenari të një filmi, personazhi kryesor është një prind që rrit fëmijën i vetëm dhe përballet me kufizime të mëdha financiare për shkak të punës që nuk paguhet mirë. Sidoqoftë, me mund të madh dhe punë këmbëngulëse, prindi, më në fund, ia del të gjejë një punë më të paguar dhe të shtojë shpenzimet për rritjen dhe edukimit e fëmijës së tij. Porosia e këtij filmi është se çdokush në jetën reale, pavarësisht sfidave, do të ketë sukses nëse përpiqet shumë dhe ngul këmbë.*

Vështuar nga aspekti sociologjik, çfarë fsheh nga jeta reale një skenar i tillë?

- (A) Pengesat e pakapërcyeshme financiare dhe në karrierë që vihen nga pozita klasore e individit
- (B) Pamjaftueshmërinë e politikave të përkujdesit social për fëmijët e prindërve me të ardhura më të ulëta
- (C) Mungesën e mbështetjes familjare për prindërit, sidomos në rastet e prindërve të vetëm
- (D) Shansin që një individ i klasës më të ulët të lëvizë duke u ngritë në një shtresë më të klasës më të lartë

## 97. Cila nga pohimet e dhëna përshkruan lëvizjet shoqërore?

- (A) Aksione individuale për përfitime ekonomike
- (B) Aktivitet kulturor në komunitete lokale shoqërore
- (C) Përpjekje kolektive për të sjellë ndryshime shoqërore ose për të ruajtur status quo-në
- (D) Grumbullim spontan i njerëzve pa qëllim të qartë

## 98. Si ndikon krimi i jakave të bardha në perceptimin e qytetarëve ndaj institucioneve publike?

- (A) Ul ndjeshëm besimin në drejtësi, transparencë dhe barazi sociale
- (B) Rrit besimin tek lidërshipi dhe autoriteti
- (C) Shkakton ndjenja të forta solidariteti dhe bashkëpunimi
- (D) Krijon ndjenjën e sigurisë në sistemin e ligjit

## 99. Ariana, 40 vjeçare, është mësimdhënëse në një shkollë të mesme. Nëna e saj ka qenë mësuese në shkollë fillore. Kur Ariana ishte 35 vjeçare, ajo punonte në një gjimnaz në Pejë, kurse sot punon në një gjimnaz në Gjakovë.

Cili nga pohimet e dhëna përshkruan llojet e mobilitetit social të Arianës në raport me nënën e saj?

- (A) Mobilitet horizontal
- (B) Mobilitet vertikal
- (C) Mobilitet tërthorazi
- (D) Mobilitet lëvizës

## 100. Cila nga alternativat më poshtë përfshin vetëm institucione shoqërore?

- (A) Moda, teknologjia, gjuha,
- (B) Klasa punëtore, banorët e fshatit, popujt
- (C) Muzika, zakonet, reklamat
- (D) Familja, arsimit, feja

## 76. Është dhënë teksti

*Sa herë shefi i Blertës i ngrinte zërin, ajo ndjente menjëherë sikur po i merrej fryma, duart i djersiteshin dhe kishte dëshirë të largohej menjëherë nga zyra. Edhe kur situata mbaronte, ajo mbetej e tensionuar për orë të tëra, e paaftë të fokusohej apo të qetësohej. Edhe në shtëpi, mjaftonte të kujtonte atë moment dhe trupi i reagoonte njësoj.*

Cilit sistem i përkasin simptomat që po ndien Blerta, bazuar në tekstin e dhënë?

- (A) Sistemit simpatik
- (B) Sistemit parasimpatik
- (C) Sistemit endokrin
- (D) Sistemit nervor qendror

## 77. Është dhënë teksti

*Një studim i publikuar në revistën Acta Biomedica në vitin 2019, thekson rëndësinë e monitorimit të funksionit të hormoneve tek adoleshentët që shfaqin simptoma të lodhjes së vazhdueshme, vështirësi në përqendrim dhe ndryshime të humorit, pasi këto mund të jenë të lidhura me çrregullime hormonale.*

Cili hormon është përgjegjës për prodhimin e këtyre simptomave tek adoleshentët, bazuar në tekstin e dhënë?

- (A) Adrenalina
- (B) Oksitocina
- (C) Prolaktina
- (D) Tiroksina

78. Në cilin lloj të kërkimit në psikologji vlerësohet lidhja midis dy ose më shumë variablave pa ndërhyrje të drejtpërdrejtë?

- (A) Eksperimental
- (B) Përshkrues
- (C) Korrelues
- (D) Biologjik

79. Në eksperimentin e tre maleve të Jean Piaget, një fëmijë 4-vjeçar i kërkohet që një model me lodra të tre maleve ta shikoj nga perspektiva e tij si dhe nga perspektiva e një kukulle. Ky eksperiment tregoi që fëmijë ishte i paaftë që të kuptonte perspektivën e kukullës, ndërsa ishte në gjendje t'a kuptojë vetëm perspektivën e tij.

Çfarë arrijmë të kuptojmë nga ky eksperiment?

- (A) Ky fëmijë është egoist
- (B) Nuk e ka zhvillimin kognitiv në përputhje me moshën
- (C) Ka probleme me identitetin
- (D) Fëmijët në këtë moshë janë egocentrikë

80. Drina shkon për herë të parë të dentisti dhe gjatë procesit ajo ndjen dhimbje. Kjo bënë që pas një kohe kur shkon përsëri te dentisti, vetëm era ose zëri i dentistit e bëjnë atë të reagoj me ankth edhe pse nuk ka dhimbje. Me çfarë lloji të të nxënës është formuar ky reagim i Drinës?

- (A) Të nxënës observues
- (B) Të nxënës kognitiv
- (C) Të nxënës në bazë të kushtëzimit klasik
- (D) Të nxënës në bazë të Kushtëzimit operant

## 81. Është dhënë teksti

*Në filmin "50 first dates", personazhi kryesor Lucy Çhitmore, pëson një aksident dhe ajo e humb aftësinë për të bërë regjistrime të reja të kujtesës. Çdo ditë që kalon, ajo rikthehet në fillim, duke harruar ditën paraprake dhe duke bërë që ajo të mendoj se është dita e fundit përpara aksidentit. Ajo jeton në një realitet të përsëritur, duke bërë që t'i harroj ngjarjet pas aksidentit, duke përfshirë edhe djaloshin i cili bën përpjekje të vazhdueshme për t'u lidhur me të, por që ajo e harron po ditën tjetër që kalon.*

Çfarë lloj amnezie ka përjetuar protagonistja e këtij filmi, bazuar në tekstin e dhënë?

- (A) Amnezi anterograde
- (B) Amnezi retrograde
- (C) Paraamnezi
- (D) Hiperamnezi

## 82. Është dhënë teksti

*Në kulturën shqiptare, kur një i afërm ndërron jetë, shprehja e dhimbjes dhe mërzisë shprehet në mënyrë më të theksuar, sidomos në zonat më tradicionale. Njerëzit qajnë me zë, mbajnë zi për disa ditë apo javë, dhe të afërmit i shprehin haptas emocionet në mënyrë të fortë. Në plot raste, gratë përdorin edhe "vajin" tradicional si formë shprehjeje e dhimbjes dhe mërzisë. Ndërsa, në disa kultura perëndimore, edhe pse ndjenja e mërzisë ekziston, ajo shpesh shprehet në formë më të përmbajtur dhe më private.*

Çfarë tregon ky shembull për mënyrën e shprehjes së emocioneve?

- (A) Emocionet bazike si trishtimi janë të pranishme vetëm në kulturat tradicionale
- (B) Emocionet bazike janë universale, por mënyra si shprehen ato ndikohet nga kultura
- (C) Njerëzit në kulturën shqiptare kanë marrëdhënie më të ngushta me familjarët e tyre
- (D) Aftësia për të ndjerë emocione nuk është e mësuar nga kultura

83. Cili drejtim psikologjik thekson se sjellja anormale vjen si rezultat i konflikteve të brendshme të pavetëdijshme?

- (A) Drejtimi biologjik
- (B) Drejtimi kognitiv
- (C) Drejtimi humanist
- (D) Drejtimi psikodinamik

## 84. Është dhënë teksti

*Një studim i kryer në vitin 1977, i quajtur Eksperimenti i kukullës Bobo kishte nxjerrë në konkluzion se fëmijët mund të mësonin sjelljet agresive duke vëzhguar sjelljet e të tjerëve. Për më tepër, eksperimenti nxori në pah se djemtë ishin më shumë të pritur t'a mësonin agresivitetin fizik, ndërsa vajzat agresivitetin verbal.*

Për cilin lloj të të mësuarit bëhet fjalë në tekstin e dhënë?

- (A) Të mësuarit kognitiv
- (B) Të mësuarit social
- (C) Të mësuarit latent
- (D) Të mësuarit përmes insajtit

## 85. Është dhënë teksti

*Arsimtari i Edukatës fizike po i vëzhgonte nga afër sjelljet e nxënësve të klasës së tij dhe sa herë që ata ndërmerrnin një veprim të mirë (p.sh ndihmonin shokun apo shoqen dhe ishin shumë të interesuar për mësimin) ai organizonte formate të reja të lojërave dhe u jepte mundësinë nxënësve që ato t'i zhvillonin edhe kur nuk kishin edukatë fizike. Ngjashëm, kur nxënësit nuk tregonin modele të mira të sjelljes, ai u hiqte këtë privilegj.*

Çka paraqet shembulli në tekstin e dhënë?

- (A) Kushtëzimin operant (veprues)
- (B) Kushtëzimin klasik
- (C) Modelimin e sjelljes
- (D) Kushtëzimin me orare fikse

86. Dr. Armendi i specializuar në fushën e Psikologjisë, po i intereson të studiojë mënyrën se si ndërveprojnë anëtarët e një grupi sportiv në mes vete, si bashkëpunojnë ata dhe mënyrën se si grupi ndikon individin dhe strategjitë e lojës. Duke pas parasysh këto specifika, në cilën fushë mendoni se do duhej të publikohej ky studim:
- (A) psikologjinë e personalitetit
  - (B) psikologjinë organizative
  - (C) psikologjinë sociale
  - (D) psikologjinë eksperimentale
87. Anisa kishte mësuar gjuhën gjermane në shkollën fillore dhe tani po mëson gjuhën italiane. Një ditë dikush e pyet si si thuhet “do shihemi përsëri” në gjuhën gjermane. Anisa e ka të vështirë të kujtohet pasi që paraprakisht i vie ndërmend si thuhet kjo fjalë vetëm në gjuhën italiane.
- Ky shembull ka të bëjë me:
- (A) amnezinë
  - (B) interferencën retroaktive
  - (C) interferencën proaktive
  - (D) akronimet
88. Ana po i shmanget detyrave nga lënda e Fizikës sepse sa herë që po mendon për këto detyra, po fillon të ketë ankth. Në këtë mënyrë ajo po vazhdon që t’ a shtyj kohën e përfundimit të detyrave duke thënë që nuk janë dhe aq të rëndësishme për te këto detyra. Cilin nga mekanizmat mbrojtës po e përdorë Ana?
- (A) Mohimin
  - (B) Projeksionin
  - (C) Represionin
  - (D) Racionalizimin
89. Studiuesit e Inteligjencës, ka shumë të ngjarë që pas 30 vitesh, gjeneratat e fëmijëve që kanë lindur në vitin 2000, t’i cilësojnë si fëmijë me inteligjencë më të lartë, krahasuar me gjeneratat e fëmijëve që nuk janë rritur në një zhvillim kaq të hovshëm të teknologjisë dhe përmirësimeve në fushën e arsimit.
- Zgjidhni konceptin për të cilin bëhet fjalë e që i përgjigjet më së miri situatës së përshkruar më lart?
- (A) Kontrollimin e njohurive
  - (B) Kufizimet në testet e inteligjencës
  - (C) Efektin Flynn
  - (D) Inteligjencën si një parashikues të mirë të të ardhurave
90. Arsimtarja e Psikologjisë, gjatë shpjegimit të lëndës, po i informon nxënësit që njerëzit që e kanë të dëmtuar pjesën dëgjimore të njërit prej lobeve, janë të dëmtuar në njohjen e sekuencave të tingujve, si në muzikë ose në të folur, e po ashtu edhe në zona të ndryshme pamore (pamundësia për të njohur fytyrat). Për cilën pjesë të lobit është duke folur më konkretisht arsimtarja e Psikologjisë:
- (A) Lobit temporal
  - (B) Lobit oksipital
  - (C) Lobit frontal
  - (D) Lobit parietal
91. Në një tekst letrar, personazhi kryesor vendos të ndihmojë një të panjohur në nevojë, duke rrezikuar sigurinë e tij. Cili është motivi më i mundshëm i këtij veprimi?
- (A) Dëshira për famë dhe lavdi
  - (B) Presioni nga shoqëria për të vepruar
  - (C) Ndjenja e empatisë dhe përgjegjësisë morale
  - (D) Frika nga ndëshkimi i mundshëm
92. Sipas Frojdit, cili personalitet zhvillohet kur superegoja dominon në mënyrë të tepruar ndaj idit?
- (A) Personalitet egoist
  - (B) Personalitet rebel
  - (C) Personalitet i shfrenuar
  - (D) Personalitet moralist

93. Si do t'a interpretonte Jung personalitetin e një nxënësi që preferon të kalojë kohë i vetëm duke reflektuar dhe lexuar libra filozofikë?
- (A) Si tip ekstrovert emocional
  - (B) Si tip ekstrovert mendimtar
  - (C) Si tip introvert mendimtar
  - (D) Si tip introvert emocional
94. Cilat janë funksionet kryesore të sistemit nervor simpatik në një situatë stresi?
- (A) Aktivizon përgjigjen e luftës ose ikjes dhe rrit ritmin e zemrës
  - (B) E bën trupin të relaksohet dhe e ngadalëson ritmin e zemrës
  - (C) Rrit prodhimin e lëngjeve të tretjes dhe përmirëson metabolizmin
  - (D) Aktivizon sistemin limbik dhe rrit ndjenjat e emocioneve pozitive
95. Si mund të ndikojë çrregullimi i balancës hormonale, për shkak të një ekspozimi të gjatë ndaj stresit, në zhvillimin e çrregullimeve emocionale dhe fizike?
- (A) Çrregullimi i hormonit të rritjes do të ndikojë negativisht në sistemin imunitar, duke bërë individin më të ndjeshëm ndaj infeksioneve, por nuk do të ketë ndikim në zhvillimin e emocioneve.
  - (B) Ndryshimet hormonale mund të çojnë në çrregullime të metabolizmit dhe të rrisin rrezikun e depresionit, sepse niveli i lartë i kortizolit ndërhyr në funksionimin e neurotransmetuesve që rregullojnë humorin.
  - (C) Përdorimi i tepruar i kortizolit do të përmirësojë kujtesën dhe do të ndihmojë në përqendrimin gjatë situatave stresuese.
  - (D) Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj stresit nuk ka ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e çrregullimeve emocionale dhe fizike.
96. Në një eksperiment, dy persona dëgjojnë të njëjtën këngë. Njëri ndjen gëzim, tjetri ankth. Cili është shpjegimi më i mirë për këtë ndryshim në perceptim?
- (A) Truri i tyre nuk e përpunon në mënyrë të njëjtë tingullin
  - (B) Ata kanë ndjeshmëri të ndryshme akustike
  - (C) Mjedisi i jashtëm është faktor dominues në këtë rast
  - (D) Përvojat, ndjenjat dhe kujtimet e tyre ndikojnë perceptimin

97. Është dhënë teksti:

*Gjatë Luftës në Ukrainë, shumë ushtarë përjetuan plagosje të rënda në kokë për shkak të predhave dhe luftës së ashpër. Një nga rastet më të njohura që ka tërhequr vëmendjen e mjekëve dhe studiuesve është ai i një oficeri, i cili pas një shpërthimi të fortë pranë tij, pësoi një goditje të rëndë në pjesën e pasme të kafkës. Pas këtij incidenti, ai nuk mund të qëndronte më në këmbë pa ndihmë, kishte vështirësi të mëdha në të ecur dhe lëvizjet e trupit të tij ishin të çrregullta, sikur të mos ishte më në kontroll të gjymtyrëve të veta. Megjithëse ai ruante të gjitha aftësitë njohëse dhe kujtesën, trupi i tij nuk i bindej më si më parë. Ky rast u bë një ndër rastet klasike në historinë e neuropsikologjisë dhe ndihmoi për të theksuar rëndësinë e kësaj pjese të trurit në funksionimin e përditshëm të trupit të njeriut.*

Bazuar në situatën e përshkruar, cila pjesë e trurit ka më shumë gjasa të jetë dëmtuar në këtë rast?

- (A) Truri i mesëm
- (B) Truri i vogël
- (C) Hipotalamusi
- (D) Truri i madh

98. Është dhënë teksti:

*Kroni raporton për lodhje të vazhdueshme, etje të shtuar dhe urinim të shpeshtë. Pas disa analizave të gjakut, rezulton se ai ka nivel të lartë të glukozës në gjak. Endokrinologu vëren se pankreasi i tij nuk po e prodhon në mënyrë të mjaftueshme hormonin që kontrollon përthithjen e glukozës nga qelizat. Kroni nis trajtimin me injeksione ditore që përmbajnë këtë hormon, i cili në kushte normale do të prodhohej në mënyrë natyrale.*

Bazuar në situatën e dhënë, cili hormon mungon dhe cilës gjëndër i përket ai?

- (A) Insulina – pankreas
- (B) Adrenalina – gjëndrat mbiveshkore
- (C) Tiroksina – tiroide
- (D) Estrogjeni – vezoret

99. Është dhënë teksti:

*Amiri ka vuajtur nga dhimbje kronike për disa vite, për shkak të një lëndimi të rëndë në shpinë. Mjeku i tij e ka këshilluar të marrë morfinë për të menaxhuar dhimbjen. Ndërkohë, Amiri ka filluar të marrë morfinë çdo ditë, duke ndjerë lehtësim të menjëhershëm të dhimbjes dhe një ndjenjë euforike. Pas disa muajsh përdorimi të vazhdueshëm, Amiri fillon të ndiejë se nuk mund të kalojë asnjë ditë pa morfinë dhe përjeton simptomat e mungesës, të vjella dhe ankth. Ai gjithashtu vërehet se ka humbur interesimin për aktivitete të tjera dhe ka ndjenja depresioni.*

Bazuar në tekstin e dhënë, cila nga këto droga është përdorur nga Amiri për të menaxhuar dhimbjen, pasojat e së cilës janë prezente për një periudhë të gjatë?

- (A) Qetësuesit
- (B) Stimuluesit
- (C) Opiatet
- (D) Halucinogjenet

100. Është dhënë teksti:

*Pas një vëzhgimi në një kopsht parashkollor, një psikolog zhvillimor vëren se një fëmijë 4-vjeçar, Ana, përdor fjali të tilla si: “Unë dua të luaj me topin”, “Mos ma merr lodrën”, dhe “Mami po vjen tani”. Ajo shpreh ide në mënyrë të qartë, ndërton fjali të lidhura logjikisht dhe shpesh herë përpiqet të tregojë ngjarje të vogla nga jeta e përditshme. Megjithatë, në një situatë tjetër ku lodra ndahet në mënyrë të pabarabartë, Ana pretendon se ajo ka më pak sepse gota e saj është më e shkurtër, edhe pse të dy fëmijët kanë të njëjtën sasi uji. Kur e pyetën: “Si mendon që ndihet shoqja jote që s’po luan me lodra?”, ajo përgjigjet: “Nuk e di... unë po luaj!” Kjo situatë është një shembull tipik i një faze të veçantë të zhvillimit të menduarit dhe të gjuhës tek fëmijët e vegjël.*

Bazuar në tekstin e dhënë, në cilin stad të zhvillimit mendor ndodhet Ana?

- (A) Stadi sensomotorik
- (B) Stadi paraoperacional
- (C) Stadi operacional konkret
- (D) Stadi operacional formal

## 76. Është dhënë teksti

Gjatë viteve të fundit në Kosovë është vërejtur një rritje e përgjithshme dhe e vazhdueshme e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve. Si pasojë, fuqia blerëse e qytetarëve ka pësuar rënie të ndjeshme, përderisa shumë familje po ballafaqohen me vështirësi për të përballuar shpenzimet mujore. Nëse një bukë ka kushtuar vitin e kaluar 1 euro dhe tani kushton 1.10 euro, kjo është një rritje çmimi prej 10%.



Nëse ky proces si në burimin e dhënë ndodhë në të gjithë ekonomin e vendit atëherë themi se ka:

- (A) deflacion
- (B) inflacion
- (C) stagnim ekonomik
- (D) recession

## 77. Çka është ekonomia e tregut?

- (A) Sistem ku shteti kontrollon të gjitha burimet e brendshme dhe te jashtme të tregut
- (B) Sistem ku vetëm ndërmarrjet shtetërore ekzistojnë
- (C) Sistem ku çmimet vendosen nga tregu, përmes ofertës dhe kërkesës
- (D) Sistem pa asnjë liri ekonomike

## 78. Cila është ndërhyrje e lejueshme e shtetit në ekonomi të tregut?

- (A) Kontrolli i plotë i prodhimit
- (B) Shndërrimi i të gjitha bizneseve private në biznese publike
- (C) Vendosja e çmimeve fikse për çdo mall dhe shërbim
- (D) Mbikëqyrja e konkurrencës dhe mbrojtja e konsumatorëve

## 79. Në tabelën e dhënë janë paraqitur dy blerës të vetëm në treg, Merkuri dhe Hana.

| Çmimi | Sasia e kërkuar e Merkurit | Sasia e kërkuar e Hanës |
|-------|----------------------------|-------------------------|
| 12€   | 2                          | 1                       |
| 10€   | 4                          | 4                       |
| 8€    | 6                          | 7                       |
| 6€    | 8                          | 8                       |
| 4€    | 10                         | 9                       |
| 2€    | 12                         | 10                      |

Duke u bazuar në të dhënat e tabelës, nëse çmimi është 8€, sa është sasia e kërkuar e tregut?

- (A) 13 njësi
- (B) 3 njësi
- (C) 22 njësi
- (D) 19 njësi

## 80. Cila është përgjegjësi sociale e firmës?

- (A) Të fshehtë fitimet
- (B) Të paguajë tatimet
- (C) Të ndotë mjedisin
- (D) Të ulë prodhimin pa arsye

81. Bilanci tregtar pozitiv ndodh kur:

- (A) importet janë më të larta se eksportet
- (B) çmimet rriten
- (C) eksportet janë më të larta se importet
- (D) shteti nuk ka fare tregti

82. Një marrëveshje tregtare ndërmjet dy apo më shumë shteteve ka për qëllim kryesor:

- (A) lehtësimin e shkëmbimeve tregtare dhe uljen e tarifave
- (B) mbylljen e kufijve tregtar
- (C) rritjen e burokracisë
- (D) ndalimin e lëvizjes së mallrave, shërbimeve dhe lëvizjen e lirë të kapitalit

83. Firma tregtare “Anita” ka blerë mallra për shitje në vlerë prej 5 000 euro me pritje

Kontabilisti i firmës tregtare “Anita” ka regjistruar transaksionin në librin e kontabilitetit.

Duke u bazuar në këtë situatë, cila nga pohimet e dhëna është e saktë për veprimin e debitit në kontabilitet?

- (A) Zbritje e pasurive dhe zbritje e detyrimeve
- (B) Zbritje e pasurive dhe rritje e detyrimeve
- (C) Rritje e pasurive dhe zbritje e detyrimeve
- (D) Rritje e pasurive dhe rritje e detyrimeve




84. Cila nga shprehjet e dhëna është një mënyrë tjetër për të thënë “kosto marginale”?

- (A) Kostoja totale
- (B) Kosto shtesë
- (C) Kosto mesatare
- (D) Mungesa

85. Në grafik është paraqitur lakorja ofertës dhe kërkesës me pikat A, B dhe C.


Çka ndodhë në grafik nëse lëvizet nga pika B në pikën A?

- (A) Rritje të çmimit
- (B) Ulje e prodhimit
- (C) Rritje e të ardhurave
- (D) Ulje të çmimit




86. Çfarë ndodh nëse kurseni 50 euro çdo muaj për një vit pa interes, sa para do të kurseni në fund të vitit, paraqitur si në grafikun e dhënë?

- (A) 500 euro
- (B) 600 euro
- (C) 650 euro
- (D) 700 euro




87. Në grafik është paraqitur ekuilibri i tregut ndërmjet ofertës dhe kërkesës



Çfarë ndodh në treg nëse një produkt shitet me çmim më të lartë se çmimi i ekuilibrit?

- (A) Do të mungojnë mallrat, sepse ka shumë blerës
- (B) Do të ketë më pak mallra për shitje se sa kërkojnë njerëzit
- (C) Do të ketë tepriçë, sepse ka më shumë mallra se blerës
- (D) Çmimi do të rritet edhe më shumë, sepse të gjithë duan ta blejnë

88. Janë dhënë grafiket A, B, C dhe D.




Cila nga grafiket paraqet Ligjin e Ofertës?

- (A) Grafiku A – Kur çmimi rritet, edhe sasia e ofruar rritet
- (B) Grafiku B – Kur çmimi rritet, sasia e ofruar zvogëlohet
- (C) Grafiku C – Paraqet vetëm kërkesën dhe nuk ka lidhje me ofertën
- (D) Grafiku D – Paraqet një rënie të kërkesës si rezultat i uljes së çmimit

89. Çka është amortizimi i kapitalit?

- (A) Shtim i vlerës së mjeteve themelore
- (B) Kapital i riinvestuar që sjell të ardhura
- (C) Investim në riparim dhe sanimin e dëmeve
- (D) Kategori e shpenzimeve dhe humbje e vlerës


90. Në grafikun e dhënë është paraqitur kurba e kërkesës



Çfarë tregon kurba e kërkesës në grafik?

- (A) Lidhjen mes të ardhurave dhe asaj që kërkohet
- (B) Lidhjen mes çmimit dhe kostos së prodhimit
- (C) Lidhjen mes çmimit dhe sasisë së kërkuar
- (D) Lidhjen mes shijeve të konsumatorit dhe asaj që kërkohet


91. Në grafikun e dhënë janë paraqitur të hyrat dhe shpenzimet



Çfarë paraqet grafiku i dhënë?

- (A) Të hyrat janë më të larta se shpenzimet
- (B) Shpenzimet janë më të larta se të hyrat
- (C) Të hyrat dhe shpenzimet janë të njëjta
- (D) Nuk ka fare të hyra në muajin e dhënë

92. Në figurë është paraqitur Lakorja e Philipsit e cila matë raportin ndërmjet papunësisë dhe inflacionit:



Çfarë ndodh me normën e papunësisë, nëse lakorja zhvendoset nga pika G në pikën H?

- (A) Uljen e papunësisë
- (B) Rritjen e papunësisë
- (C) Efekti në papunësi është zero
- (D) Ndikon në uljen e çmimeve


93. Cila nga masat përdoret nga shteti më shpesh për të kufizuar importet nga një vend?

- (A) Vendosja e kuotave të importit
- (B) Liberalizimi i tregtisë
- (C) Ulja e taksave doganore
- (D) Subvencionimi i eksporteve

94. Kush i përcakton normat e interesit për kredi në Kosovë?

- (A) Qeveria e Kosovës – Ministria e Financave
- (B) Banka Qendrore e Kosovës (BQK)
- (C) Bankat komerciale, sipas kushteve të tregut
- (D) Kuvendi i Republikës së Kosovës

95. Në grafikun e dhënë është paraqitur kostoja fikse dhe variabile.



Çka është kostoja variabile, bazuar në grafikun e dhënë?

- (A) Shpenzim që mbetet konstant pavarësisht sasisë së prodhimit
- (B) Shpenzim që ndryshon në varësi të sasisë së prodhimit
- (C) Fitimi i kompanisë pas shitjeve
- (D) Shpenzim që lidhet vetëm me investimet afatgjata

96. Çka mat GDP-ja - Produkti i Brendshëm Bruto?

- (A) Të gjitha shpenzimet e qeverisë
- (B) Numrin e njerëzve që jetojnë në një vend tjetër
- (C) Sasinë e parave të dërguara nga vendet tjera
- (D) Vlerën e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara në një vend

97. Cilës politikë makroekonomike i takojnë tatimet dhe taksat?

- (A) Politikës monetare
- (B) Politikës së marrëdhënieve me jashtë
- (C) Politikës fiskale
- (D) Politikës së të ardhurave

98. Tabela e dhënë tregon kërkesën dhe ofertën për kompjuter:

| Çmimi | Sasia e ofruar | Sasia e kërkuar |
|-------|----------------|-----------------|
| 999   | 2000           | 2800            |
| 780   | 1500           | 3200            |
| 650   | 2300           | 2300            |
| 570   | 1600           | 1900            |

Sa do të jetë çmimi ekuilibruar mes sasisë së ofruar dhe sasisë së kërkuar për kompjuter, bazuar në tabelën e dhënë?

- (A) 780 euro
- (B) 650 euro
- (C) 999 euro
- (D) 570 euro

99. Në tabelën e dhënë janë paraqitur të ardhurat dhe shpenzimet.

| Të ardhurat           |       | Shpenzimet             |       |
|-----------------------|-------|------------------------|-------|
| Të hyrat nga shitja   | 3,500 | KMSH                   | 1,900 |
| Të hyrat nga interesi | 1,000 | Shpenzimet e pagave    | 1500  |
| Të hyrat nga qiraja   | 900   | Shpenzimet e interesit | 400   |

Cilës pasqyrë financiare i takojnë të dhënat e paraqitura në tabelë?

- (A) Bilanci i gjendjes
- (B) Pasqyra e rrjedhës së parasë
- (C) Pasqyra e ndryshimeve në ekujtet
- (D) Bilanci i suksesit

100. Çfarë është taksa?

- (A) Një pagesë që bëhet me dëshirë
- (B) Një pagesë që detyrohet nga shteti
- (C) Një shpërblim për punëtorët
- (D) Një dhuratë për qeverinë

76.

**Berati**

Në fotografinë e dhënë është paraqitur Berati, qytet në Shqipëri, i cili është nën mbrojtje të UNESCO-s që nga viti 2008.



Pse qyteti i Beratit është përfshirë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s?

- (A) Sepse është kryeqyteti më i vjetër i Ballkanit
- (B) Për shkak të pasurive të tij natyrore dhe minerare
- (C) Për zhvillimin e industrisë moderne në rajon
- (D) Për arkitekturën e veçantë dhe historinë kulturore

77. Në fotografinë e dhënë është paraqitur një veprim i zakonshëm i qytetarëve për të mbrojtur mjedisin.



Për çfarë veprimi bëhet fjalë?

- (A) Përfshirjen e praktikave të riciklimit për të minimizuar mbeturinat
- (B) Përfshirjen e praktikave të hedhjes së mbeturinave në vende të pacaktuara
- (C) Grumbullimin e mjeteve të ndryshme plastike që nuk janë të riciklueshme
- (D) Përdorimin e transportit privat për t'ju shmangur transportit publik dhe biçikletave

78. Në fotografitë e dhëna janë paraqitur figura të shquara që kanë qenë simbole të rezistencës paqësore, luftës kundër diskriminimit dhe të kujdesit për të varfrit.

Cila nga fotot e dhëna, paraqet personalitetin e njohur për aktivitetet dhe politikat anti-aparteid në Afrikën e Jugut?

- (A) Foto.1 Mahatma Gandi
- (B) Foto.2 Nelson Mandela
- (C) Foto.3 Martin Luter King
- (D) Foto.4 Nënë Tereza




Foto.1 Mahatma Gandi



Foto.2 Nelson Mandela



Foto.3 Martin Luter King




Foto.4 Nënë Tereza

## 79. Është dhënë teksti

*Idetë e gatshme që njerëzit kanë për dikë, vetëm sepse ai person bën pjesë në një grup të caktuar, në shembujt përgjithësues si:*

- *gratë nuk janë të mira në matematikë*
- *burrat nuk qajnë*
- *të gjithë gjermanët janë të flohtë*
- *të rinjtë janë dembelë*



Me çka kanë të bëjnë shembujt në tekstin e dhënë?

- (A) stereotipe
- (B) ideotipe
- (C) prototipe
- (D) arketipe

80. Me cilin prej akteve juridike të njohura si 'kod', përcaktohet e drejta e emrit, trashëgimisë, pronës, shtetësisë, vendbanimit, etj?

- (A) Kodin e Procedurës Penale
- (B) Kodin e Familjes
- (C) Kodin Penal
- (D) Kodin Civil

## 81. Është dhënë teksti

***Policia e Kosovës***

*Në fotografinë e dhënë është paraqitur aplikacioni i Policisë së Kosovës, përmes të cilit qytetarët mund të raportojnë për akte dhune, vjedhje, problem në komunikacion, trafikim të drogës, armëve, afera të korrupsionit etj. Këtë aplikacion e përdori Beni, i cili hasi në vështirësi për ta dërguar fëmijën e tij në shkollë, meqë një veturë me ngjyrë të zezë, ishte parkuar përpara hyrjes së shkollës e që rrezikonte fëmijët që dilnin nga shkolla. Ai i bëri një foto veturës së parkuar dhe e dërgoi në aplikacionin "Lajmëro Policinë".*



Cili është veprimi i duhur që duhet të ndër marrë zyrtari policor pas pranimit të raportit në aplikacionin "Lajmëro Policinë" si në tekstin e dhënë?

- (A) Të injorojë raportin meqë nuk ka ndodhur asnjë aksident dhe nuk përbën ndonjë rrezik të madh
- (B) Të kontaktojë qytetarin për të marrë në pyetje personalisht për arsyet e parkimit të veturës
- (C) Të verifikojë raportin përmes vendndodhjes dhe fotos, pastaj të marrë masa sipas ligjit për kundërvajtje në trafik
- (D) Të kërkojë nga qytetari që ta largojë vetë veturën nga hyrja e shkollës ku ishte parkuar

82. Partitë politike janë organizata të strukturuar që bashkojnë individë me bindje të ngjashme ideopolitike, me qëllim të marrjes së pushtetit dhe zbatimit të një programi qeverisës në përputhje me ato bindje. Në varësi të orientimit ideologjik dhe prioriteteve programore, partitë zakonisht klasifikohen në:

- (A) në parti pozitare dhe opozitare
- (B) parti të majta, të djathta dhe të qendrës
- (C) parti parlamentare dhe jashtëparlamentare
- (D) parti nacionaliste dhe jo nacionaliste

83. Që nga viti 1999, bashkësia ndërkombëtare ka vendosur në Kosovë disa misione, të cilat edhe sot bashkëpunojnë me institucionet e vendit në fushën e sigurisë, politikës dhe drejtësisë. Këto misione janë:

1. EULEX
2. KFOR
3. UNMIK

Cila është renditja e saktë në bazë të kronologjisë kohore të zbarkimit në Kosovë të këtyre misioneve, duke filluar nga më i vjetri tek më i ri?

- (A) 1-2-3
- (B) 1-3-2
- (C) 2-1-3
- (D) 2-3-1

84. Flutura është një qytetare e Kosovës, e cila kishte hyrë në garë për deputete të Kuvendit të Kosovës si kandidate e pavarur. Për Fluturën mund të votonte cilido prej qytetarëve nga cilado komunë e Kosovës.

Kjo bëhet e mundur për shkak se në Kosovë aplikohet sistemi elektoral me:

- (A) 1 zonë zgjedhore me lista të hapura
- (B) 36 zona zgjedhore me lista të mbyllura
- (C) 36 zona zgjedhore me lista të hapura
- (D) 1 zonë zgjedhore me lista të mbyllura

85. Në kuadër të përshkrimit të kompetencave të Kuvendit të Kosovës, në nenin 65, pika (7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është specifikuar njëra nga kompetencat kryesore të Kuvendit, ku thuhet se Kuvendi “zgjedh dhe mund të shkarkojë Presidentin e Republikës së Kosovës në pajtim me këtë Kushtetutë”.

Çfarë republike është Kosova në bazë të këtyre kompetencave që i përshkruan kushtetuta?

- (A) Republikë gjysmë-parlamentare
- (B) Republikë gjysmë-presidenciale
- (C) Republikë Parlamentare
- (D) Republikë Presidenciale

86.

### ***Xhubleta***

*Fotoja e dhënë paraqet ‘Xhubletën shqiptare’, një veshje 4 mijë vjeçare e vjetër. Kjo veshje është marrë nën mbrojtje të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO). Xhubleta u pranua në listën e Trashëgimisë Kulturore ‘jomateriale’ nën mbrojtjen e UNESCO-s, me ç ‘rast u bë pasuri e gjithë njerëzimit.*



Pse është e rëndësishëm për shqiptarët marrja nën mbrojtje e Xhubletës nga UNESCO?

- (A) Promovon vlerat kulturore dhe historike mijëvjeçare të shqiptarëve
- (B) Promovon vlera artizanale të huazuara të shqiptarëve
- (C) Promovon vlera artizanale të kohës moderne të shqiptarëve
- (D) Promovon vlera multikulturore të imituara nga shqiptarët

87. Si njihet një grup qytetarësh me interesa të përbashkëta dhe që synon ta ndikojë politikbërjen shtetërore për të arritur një qëllim në përputhje me rrugët ligjore?

- (A) Turmë spontane
- (B) Grup i interesit
- (C) Klan kriminal
- (D) Klan mafioz

88. Pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve parlamentare në Kosovë, të mbajtura me 9 shkurt, 2025, nga Kuvendi i Kosovës pritet të votohet qeveria e re. Kuvendi i Kosovës aktualisht i ka 120 deputet. Për ta votuar qeverinë e re, do të duhej shumica e thjeshtë, sipas formulës 50%+1 votë.

Sa deputet do të duhej të votonin pro për zgjedhjen e qeverisë sipas kësaj formule?

- (A) 61 deputet
- (B) 93 deputet
- (C) 101 deputet
- (D) 120 deputet

89.

*Fotografia e dhënë paraqet kryeministrin e Izraelit, ndaj të cilit është lëshuar një urdhër-arrest me 21 nëntor të vitit 2024, me akuzën për akte që përfshijnë vrasjen, persekutimin dhe urinë si një armë lufte, si dhe sulmet e gjera dhe sistematik kundër civilëve palestinezë në Gaza.*



Cili nga institucionet e mëposhtme e lëshoj këtë urdhër?

- (A) Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
- (B) Gjykata Evropiane e Drejtësisë
- (C) Gjykata Penale Ndërkombëtare
- (D) Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

90. Në foton e dhënë është paraqitur njëra nga samitet e G20, i mbajtur në Rio De Janeiro-2024.



Cili është qëllimi kryesor i takimeve të samitit të G20?

- (A) Të zgjidhin qeshtie të brendshëm të një shteti të vetëm
- (B) Të diskutojnë zhvillimin ekonomik global dhe bashkëpunimin ndërkombëtar
- (C) Të organizojnë mbrojtjen ushtarake të përbashkët për planetin tokë
- (D) Të marr vendime në rast se pamundësohet votimi në Këshillin e Sigurimit të OKB-së

91. Liria, demokracia, liria e mediave, të drejtat e njeriut, pluralizmi politik etj., do të mund të afirmoheshin dhe garantoheshin edhe më shumë nëse Kosova do të anëtarësohej në forume që mbrojnë këto kauza dhe vlera. Cila prej institucioneve të dhëna më poshtë merret me promovimin dhe garantimin e këtyre vlerave?
- (A) UNESCO  
(B) UNICEF  
(C) Këshilli i Sigurimit të OKB-së  
(D) Këshilli i Evropës
92. Presidenti amerikan, Donald Trump, vendosi masa tarifore të ndryshme për pothuajse secilin vend që ka marrëdhënie tregtare me ShBA-të, duke e përfshirë edhe një tarifë prej 10% ndaj Kosovës. Çka nënkupton jo tarifë?
- (A) Që Kosova nuk mund të importoj dhe eksportoj në ShBA për 10 vjet  
(B) Që Kosova i paguan një tarifë 10 % ShBA-s për produktet që importon nga ShBA-të  
(C) Që Kosova paguan një tarifë 10 % ShBA-ve për produktet e saj që eksporton në ShBA  
(D) Që Kosova nuk i paguan ShBA-së tarifën 10 % as për produktet e saj të importit as për ato të eksportit
93. Koncepti modern i të drejtave të njeriut, që sot ne e njohim përmes *Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut*, erdhi si rezultat i reflektimit ndaj mizorive të shkaktuara sidomos ndërmjet viteve 1939-1945. Gjatë cilës luftë ndodhën këto mizori?
- (A) Luftës së Dytë Botërore  
(B) Luftës së Parë Botërore  
(C) Luftës së Ftohtë  
(D) Luftës së Trëndafilave
94. Anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës do të kishte rëndësi të veçantë për vendin tonë. Çka do të mundësonte për Kosovën nëse ajo bëhet anëtare e kësaj organizate?
- (A) Që Kosova do të bëhej pjesë e një aleance politiko-ushtarake evropiane  
(B) Që Kosova do të bëhej pjesë e tregut më të pasur në Evropë  
(C) Që Kosova do të bëhej pjesë e një forumi kulturor dhe artistik evropian  
(D) Që Kosova do të bëhej pjesë e njërit prej forumeve politike rajonal më të rëndësishme
95. Vesa është një nxënëse e cila ka lindur dhe jeton në Republikën e Kosovës. Në terma juridik, ajo ka një lidhje me vendin e saj ku ka lindur, për faktin se ajo posedon të gjitha dokumentet e identifikimit të Republikës së Kosovës. Si quhet kjo lidhje juridike e Vesës me Republikën e Kosovës?
- (A) Kombësi  
(B) Shtetësi  
(C) Ri-atdhesim  
(D) Leje qëndrim
96. Simboli i dhënë në vijim ka qenë identifikuesi i protestës masive paqësore qytetare, e cila u mbajt në Prishtinë, me datë 5 prill 2025. Kjo protestë u organizua në shenjë revolte ndaj një vendimi të autoriteteve shtetërore për të shtrenjtuar një produkt për 15%. Kundër rritjes së çmimit të cilit produkt u protestua në këtë datë?



97. Roza dhe Bleta janë fqinje dhe jetojnë në qytetin e Pejës. Pas një kontesti pronësor në mes vete, Roza vendosi ta padisë Bletën në gjykatë për të kërkuar drejtësi. Gjykata e pranoi lëndën e Rozës. Cila është instanca gjyqësore ku Roza do të duhej të paraqiste fillimisht padinë e saj?
- (A) Gjykata Themelore
  - (B) Gjykata Kushtetuese
  - (C) Gjykata e Apelit
  - (D) Gjykata Supreme
98. Në vitin 2025, trupi gjykues në një gjykatë në Kosovë, një personi që kishte kryer vrasje të rëndë, ia shpalli dënimin kapital sipas ligjeve në fuqi në vendin tonë. Cila është shkalla më e lartë e këtij dënimi?
- (A) Me vdekje
  - (B) Me burgim të përjetshëm
  - (C) Me gjobë 1 milion euro
  - (D) Me burgim 100 vjet
99. Kuvendi i Kosovës përbëhet vetëm nga një dhomë me 120 deputet, në të cilën përfaqësohen qytetarët nga e gjithë Kosova. Përmes një reforme kushtetuese, do të ishte e mundur të riorganizohej struktura e kuvendit, ku do ti shtohej edhe një dhomë tjetër e dytë, por në të cilën do të përfaqësoheshin 38 komunat e Kosovës me nga 2 përfaqësues. Si do të quhej kjo dhomë e dytë?
- (A) Dhoma e vogël
  - (B) Dhoma e madhe
  - (C) Dhoma e lartë
  - (D) Dhoma e ultë
100. Në ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë të vitit 2008, është përcaktuar se komunat i ushtrojnë kompetencat e tyre që janë:
- *vetanake,*
  - *të deleguara dhe*
  - *të zgjeruara, në përputhje me këtë ligj*
- Cilat nga aktivitetet e dhëna është përcaktuar të jenë në kuadër të kompetencave vetanake?
- (A) Distribrimi i pagesave të ndihmës sociale me përjashtim të pensioneve
  - (B) Shënimet kadastrale dhe regjistrimin civil
  - (C) Regjistrimi i bizneseve dhe licencimet
  - (D) Planifikimi urban, rural si dhe zbatimi i rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit

76. Cila është okarina (instrumenti muzikor frymor) më i vjetër në Evropë e paraqitur në foto? Fig.1

- (A) Okarina e Runikut në Kosovë
- (B) Okarina e Budrio-s në Itali
- (C) Okarina e Gjon Tejllor-it në Angli
- (D) Okarina në Gjermani e shek. XV



Fig.1

*Pyetja 77 dhe 78 i referohen figurës nr.2*

77. Si quhet vepra e paraqitur në foto?

- (A) Panteoni Romak
- (B) Amfiteatri i Apolonisë
- (C) Odeoni Ilir
- (D) Koloseu Romak



Fig.2

78. Cilat ishin karakteristikat kryesore të artit Klasik Grek?

- (A) Skulpturat njerëzore ishin arkaike, në ndërtime nuk përdoreheshin harqet, shtyllat ishin prezente në të katër anët e tempujve
- (B) Ndjekja e idealeve të proporcionit, kontraposto (ekulibër asimetrik) dhe përdorimi i stileve dorik dhe jonik
- (C) Vazot me figura të zeza, u sforcau stili korintik
- (D) Influencoj artin e Mesopotomisë, skulptura miniature në fildish dhe eshtra

79. Me cilat veçori dallohej Arti Bizantin?

- (A) Mveshjen e mureve të jashtme të kishave me mozaiket me xhama të ngjyrosura
- (B) Paraqitja poshtë në mure e figures së Krishtit ndërsa, engjujtë në kupolë
- (C) Me figurat e njerëzve tre-dimensional, shquanin fizikun e jo shpirtëroren, ikonat nuk ishin objekt nderimi por, vetëm dekorime
- (D) Me përdorimin e ngjyrës së arit për të krijuar ndjenjën e dritës hyjnore, pikturat dy-dimensionale, ikonat si art qendror

*Pyetjet 80 dhe 81 i referohen pikturës së paraqitur në figurën nr.3*

80. Kush është autor i skulpturës së paraqitur në foto?

- (A) Mikelanxhelo Bounaroti
- (B) Lorenzo Bernini
- (C) Andrea Aleksi
- (D) David Selenica

81. Skulptura e paraqitur në foto njihet si:

- (A) portreti i parë i Skënderbeut
- (B) portreti i parë i Aleksandrit
- (C) portreti i parë i Konstandinit
- (D) portreti i parë i Justinianit




Fig.3

82. Cilat nga karakteristikat e mëposhtme e përshkruajnë Artin e Renesancës?

- (A) Art më shumë simbolik sesa përshkruar i realitetit dhe vetëm me temat religjioze, figurat pa volum dhe pa perspektivë me një pikë
- (B) Veprat realiste me simetri, proporcione, harmoni, perspektivë lineare, përdorimi i ngjyrave të vajit, kiaroskuro, skulptura në madhësi natyrore
- (C) Arti skulptural pa parashkurtesa të gjymtyrëve dhe draperia e vrazhdë pa detaje të shumta
- (D) Arti i cili nuk e njihete kontraposton dhe ishte art pa iluzionin e thellësisë

*Pyetjet 83 dhe 84 i referohen imazhit të paraqitur në figurën nr.4*

83. Kush është autori i skulpturës së paraqitur në foto?

- (A) Bernini
- (B) Canova
- (C) Mikelanxhelo
- (D) Borromini

84. Cilat janë karakteristikat kryesore të kësaj skulpture?

- (A) Thellësia dhe butësia emocionale
- (B) Mungesa e harmonisë dhe ekuilibrit të figurave
- (C) Mungesa e natyralizmit të idealizuar
- (D) Kontraposto dhe lëvizja dinamike



Fig.4

85. Cilin regjion apo shtet i takojnë pikturat e Renesancës në foto? Fig.5

- (A) Renesancës Gjermane
- (B) Renesancës së Italisë
- (C) Renesancës Franceze
- (D) Renesancës së Flandrisë



Fig.5

86. Si të njohësh një ndërtesë të Arkitekturës së Barokut?

- (A) Ndërtesat këndore dhe katërkëndëshe me kolonat klasike në hyrje të objektit është karakteristikë njohëse
- (B) Planimetri me forma komplekse, ovale, hapësira me lakesa, përdredhje dhe statuja të praruara
- (C) Ndërtesa me simetri neoklasike me shtylla të stilit dorik, dritare drejtkëndëshe
- (D) Me çati rrafsh nën të cilën gjendet dhoma rrethore nga e cila shifet lartësia e ndërtesës nga brenda

87. Pikturoi me modele të gjalla, direkt në pëlhurë dhe pa skica. Punoi subjektet në boshte të dritës dhe hijeve të errëta (tenebrizëm). Stili i tij ishte inspirim për shumë artistë të barokut. Ndër tjerash pikturoi “Shportën me Fruta”. Për cilin artist bëhet fjalë? Fig.6

- (A) Mikelangjelo Buonarroti
- (B) Guido Reni
- (C) Anibal Karraçi
- (D) Mikelangjelo Karavagjo



Fig.6

88. Ishte piktor i barokut holandez i shekullit XVII dhe i influencuar nga piktorët-mjeshtërve të vjetër italian, flaman dhe holandez të cilët kishin studiuar në Itali. Cili ishte piktori që pikturoi veprën “Agat Bas”? Fig.7

- (A) Frans Hals
- (B) Antoni van Dajk
- (C) Rembrant van Rijn
- (D) Jakob van Rausdal



Fig.7

*Pyetjet nga nr. 89, 90 dhe 91 i referohen pikturës së paraqitur në figurën nr.8*

89. Cili artist e realizoi veprën e paraqitur në foto?

- (A) Zhak Lui David
- (B) Zhan August Ingre
- (C) Francisko Goja
- (D) Diego Velaskezi

90. Për nga stili i pikturimit, cilës periudhë arti i takon kjo vepër?

- (A) Neoekspresionizmit
- (B) Neoplasticizmit
- (C) Neoklasicizmit
- (D) Neoimpresionizmit

Fig.8

91. Analizoni pikturën e paraqitur në foto dhe gjeni se cilat janë karakteristikat kryesore me të cilat dallohet kjo vepër?

- (A) Ngjyra akromatike dhe tonet harmonike
- (B) Intensiteti emocional dhe kontrasti dramatik
- (C) Paraqitje hyjnore me kontraste tonale të buta
- (D) Shtrembërimi anatomik me përmasa të deformuara



92. Çilat rrethana shoqërore inicuan në shumëllojshmëritë e stilit arkitektonik të shekullit XIX?

- (A) Revolucioni industrial që ndikoj në materialet dhe metodat e reja të ndërtimit dhe ringjallja e stileve historike si Gotik, Roman dhe Neoklasik
- (B) Reformimi i kishës Protestante. Ndërtimet e mëdha me hapësira kontraste, me elemente të përdredhura, të lakuara, ovale të pasura me statueta
- (C) Stabiliteti i shoqërisë nën Dinastinë e Tudorëve që ndikoi në formimin e stilit Tudor në arkitekturë
- (D) Prosperiteti i shoqërisë nën udhëheqjen e Mbretëreshës Elizabeta e I-rë që ndikoi në formimin e stilit Elizabetian

93. Cilat ishin karakteristikat e Impresionizmit?

- (A) Fokusi në vijat, trajtat dhe ngjyrat e fuqishme të manifestuara pa qenë nevoja të imitojë ngjashmëritë me pamjet e realitetit
- (B) Lëvizje të shpejta të brushave, ndriçimi, pikturimi në natyrë, fokusimi në kalimin e dritës dhe efektet e saja në ngjyra
- (C) Paraqitje të proporcioneve të zgjatura dhe të shtrembëruara me ngjyra të gjalla dhe misteri në vepra
- (D) Vijat fluide organike, forma gjeometrike në kompozicione asimetrike me strukturim dhe ornamente

*Pyetjet 94 dhe 95 i referohen fotos së paraqitur në figurën nr.9*

94. Kush është autori që realizoi pikturën në foto?

- (A) Klod Mone
- (B) Edgar Degas
- (C) Pol Gogen
- (D) Eduard Monet

95. Analizoni pikturën e paraqitur në foto dhe gjeni se cilat janë karakteristikat kryesore me të cilat dallohet kjo vepër?

- (A) Perspektiva e zogut dhe ngjyra të zbehta
- (B) Penelata të lirshme dhe ngjyra të ndritshme
- (C) Penelata me elemente postmoderniste
- (D) Perspektiva e bretkocës dhe sfumato



Fig.9

96. Cilat janë dy lëvizjet artistike të cilat ndikuan drejtpërdrejt në lindjen e artit abstrakt?

- (A) Romantizmi dhe Minimalizmi
- (B) Neoklasicismi dhe Neoimpresionizmi
- (C) Kubizmi dhe Fauvizmi
- (D) Manierizmi dhe Futurizmi

97. Përshkruani cilat ishin veçoritë e arkitekturës së shekullit XX.

- (A) Parafabrikimi në ndërtime, me forma, struktura dhe stile inovative funksionale
- (B) Stilet arkitektonike historike me ringjallje të Gotikës
- (C) Stili Kolonial dhe Stili Viktorian
- (D) Neoklasika me simetri dhe Jugendstil

98. Cila lëvizje artistike shpërfaqte realitetin me asimetrinë e balancuar me vija, ngjyra dhe trajta për të paraqitur të vërtetën univerzale dhe absolute? Fig.10

- (A) Abstrakt Ekspresionizmi
- (B) Konstruktivizmi
- (C) Stili internacional
- (D) Neoplasticizmi



Fig.10

*Pyetjet me nr. 99 dhe 100 i referohen veprës së paraqitur në figurën nr. 11*

99. Cili artist e realizoi pikturën me titullin “Sofra” të paraqitur në foto?

- (A) Gjelo Gjokaj
- (B) Agim Çavdarbasha
- (C) Adem Kastrati
- (D) Muslim Mulliqi





100. Analizoni pikturën e paraqitur në foto dhe gjeni se cila është karakteristika kryesore me të cilat dallohet kjo vepër?

- (A) Perspektiva lineare e sfondit
- (B) Natyralizmi dhe realizmi i portreteve
- (C) Sfondi i zbrazët pa perspektivë
- (D) Ngjyrat akromatike me detaje të theksuara



Fig.11





76. Në cilin opcion është shkruar saktë nota Fa e oktavës së parë ?

- (A) 
- (B) 
- (C) 
- (D) 

77. Në cilin opcion është dhënë saktë distanca e gjysëm tonit diatonik?

- (A) 
- (B) 
- (C) 
- (D) 

78. Në cilin opcion është ndarë saktë masa 4/4 ?

- (A) 
- (B) 
- (C) 
- (D) 

79. Në cilën shkallë është dhënë ky fragment muzikor?

- (A) g-mol
- (B) B-dur
- (C) e-mol
- (D) F-dur

J. S. BACH  
Gavota


Allegro



The musical score shows two staves in G major (one sharp). The first staff starts with a mezzo-piano (*mp*) dynamic and features a forte (*f*) dynamic in the second measure. The second staff starts with a mezzo-piano (*mp*) dynamic and features a mezzo-forte (*mf*) dynamic in the second measure.

80. Cila shkallë e vjetër kishtarë (modus) është dhënë në këtë shembull?

- (A) Modusi friggjik
- (B) Modusi miksolidik
- (C) Modusi eolik
- (D) Modusi lidik



81. Në cilin opion është dhënë saktë rënditja e tingujve të shkallës fis-mol melodike?

- (A) fis-gis-a-h-cis-dis-eis-fis
- (B) fis-gis-a-h-cis-dis-e-fis
- (C) fis-gis-a-h-c-d-eis-fis
- (D) fis-g-a-h-cis-dis-eis-fis

82. Si duhet të jetë renditja e saktë, sipas radhës, e 4 bemolëve në një shkallë ?

- (A) B-As-Es-Ges
- (B) B-As-Des-Es
- (C) B-Es-As-Ges
- (D) B-Es-As-Des

83. Cili interval është dhënë në këtë shembull?

- (A) Sekstë e madhe
- (B) Sekstë e zvogëluar
- (C) Sekstë e vogël
- (D) Sekstë e zmadhuar



84. Në cilin opion është dhënë saktë intervali i kuartës së zmadhuar nga tingulli “*f*”?

- (A) f – his
- (B) f – ces
- (C) f – b
- (D) f – h

85. Cili nga opcionet (A, B, C, D) e paraqet tercën e zmadhuar telartë nga tingulli “e”?

- (A) e – gisis
- (B) e – gis
- (C) e – a
- (D) e – as

86. Nëse do ta rrotullonim intervalin **fis-c** në **c-fis**, cilin interval do ta fitonim?

- (A) Kuartën e pastër
- (B) Kuartën e zmadhuar
- (C) Kuintën e zmadhuar
- (D) Kuintën e pastër

87. Cili kuintakord është dhënë në këtë shembull?

Vini re: 5/3 m = i madh, 5/3 v = i vogël, 5/3 zm = i zmadhuar, 5/3 zv = i zvogëluar.

- (A) 5/3 zm
- (B) 5/3 m
- (C) 5/3 v
- (D) 5/3 zv



88. Bashkëtingullima e tingujve **d-fis-a-c** është:

- (A) Septakord
- (B) Kuintakord
- (C) Sekstakord
- (D) Nonakord

89. Bashkëtingullima e tingujve **f-a-c-d-e** është:


- (A) Sekstakord
- (B) Septakord
- (C) Kuintakord
- (D) Nonakord

90. Në opsionet e dhëna, cila është lidhje e kuintakordeve kryesore?

- (A) I – IV – V
- (B) I – II – V
- (C) I - III – V
- (D) I – VI - V

91. Çfarë lidhje harmonike është dhënë në këtë shembull? (shkalla d-mol)

- (A) Lidhje e kombinuar
- (B) Lidhje e lirë
- (C) Lidhje gjysëm e lirë
- (D) Lidhje e rreptë



T S

92. Cili prej llojeve të sekstakordit është dhënë në këtë shembull? (shkalla f-mol)

- (A) Seksta paraardhëse
- (B) Seksta azhute
- (C) Seksta kalimtare
- (D) Seksta e braktisur



5 6  
T — S

93. Cili prej llojeve të kuartsekstakordit është dhënë në këtë shembull? (shkalla h-mol)

- (A) Kuartsekstakordi mbajtës gjysëm i përgatitur
- (B) Kuartsekstakordi mbajtës i përgatitur
- (C) Kuartsekstakordi kthyes
- (D) Kuartsekstakordi mbajtës i papërgatitur



6 5  
4 #3  
T D —

94. Cila kadencë është dhënë në këtë shembull?

- (A) Kadencë autentike e plotë
- (B) Kadencë plagale
- (C) Kadencë e zgjeruar
- (D) Kadencë autentike



T S D VI II VII T

95. Cili rrotullim i septakordit dominant është dhënë në këtë shembull? (shkalla e-mol)

- (A) Kuintsekstakordi dominant
- (B) Sekondakordi dominant
- (C) Terckuartakordi dominant
- (D) Septakordi dominant



96. Si emërtohen këto kuinta paralele në lëndën e harmonisë? (shkalla D-dur)

*Vëmendje: shiqo akordin në cilën gradë të shkallës është dhënë dhe përcaktohu për përgjigjen.*

- (A) Kuintat e Mozartit
- (B) Kuintat antiparalele
- (C) Kuintat paralele
- (D) Kuintat e Skarlatit



97. Cili rrotullim i nonakordit dominant është dhënë në këtë shembull? (shkalla F-dur)

- (A) Nonakordi dominant
- (B) Kuartkuintakordi dominant
- (C) Sekstseptakordi dominant
- (D) Sekondtercakordi dominant



98. Dominanta jashtëtonale për cilën gradë është dhënë në këtë shembull? (shkalla g-mol)

- (A) Dominanta jashtëtonale për gradën e katërt
- (B) Dominanta jashtëtonale për gradën e pestë
- (C) Dominanta jashtëtonale për gradën e dytë
- (D) Dominanta jashtëtonale për gradën e gjashtë



b 7

99. Cili lloj i akordit të alteruar është dhënë në këtë shembull? (shkalla G-dur)


- (A) Sekstakordi i gradës dytë
- (B) Sekstakordi Napolitan
- (C) Sekstakordi Lidik
- (D) Sekstakordi i dominantës së dominantës



b 6  
b

100. Cili interval është dhënë në figurë?

- (A) Kuartë e zmadhuar
- (B) Kuintë e zvogëluar
- (C) Kuartë e pastër
- (D) Kuintë e pastër





Qershor, 2025